# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7729 E mërkurë 5 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)










Opinioni i Ditës

Nga ADRI NURELLARI



## Hapësira e pashfrytëzuar e forcimit të lidhjes Shqipëri-Kosovë

Para pak ditësh lamë pas festën tonë kombëtare, mbledhjen mes dy qeverive të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe tanimë ...

Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga GAZMEND KAPLLANI



## Janullatos, a nuk i vrasin edhe shqiptarët kështu?

Pak ditë më parë në Korfuz të Greqisë, një 62-vjeçar emigrant shqiptar, Petrit Zilfa, u ther si qen dhe u hodh në hendek nga një nazist i Agimit të Artë ...

Vijon në faqen 21

KREU I ALUIZNI-t: GJYSMA E TOKAVE NE FSHAT NUK JANE TE REGJISTRUARA

# LAME: 2.5 MILIONE PRONA ME PROBLEME NE SHQIPERI

Banesat në Shkozë, Artan Lame: Kush janë familjet që marrin certifikatën e pronësisë. 40 mijë ndërtime para vitit '91, të gjitha të paregjistruara



(Në foto) Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame

Në faqet 4-5



Opozita: U shemb shtëpia e Havzi Nelës

## Prishja e ndërtimeve, 3 protesta në Tiranë. Lubonja vesh jelekun, u bashkohet banorëve

Banorët që preken nga projektet e rrugëve u vënë flakën kazanëve: Luftë po erdhët sërish

VALENTINA MADANI

Deputetët e opozitës u shpërndanë dje në tri vatrat e protestës që po zhvillohen njëherësh në Tiranë, në mbrojtje të banesave të tyre, që preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe. Një grup deputetësh ishin dje në zonën ...

Në faqet 2-3

PERBALLJA NE "NEWS 24"

## Masakra në Mamurras, motra e 2 autorëve: Frikë nga gjakmarrja. Reagon i ati i viktimës

Në faqen 6

TIRANE

## Maskat dhunojnë e grabitin dyqanin, flet tregtari: Më goditën në kokë

Në faqen 7

INTERVISTA

## Vazhdon eksodi i infermierëve, kreu i shoqatës: Do përgjysmohet stafi

Në faqen 9

KESTI I TRETE




## Trashëgimtarët e të përndjekurve, emrat që marrin dëmshpërblimin

Në faqet 10-11

Drejtuesit e agjencive të lajmeve të 13 vendeve mbushin gotat: Shije e veçantë

## Reporterët europianë, vizitë në birra "Korça"

*"Fabrika është një aset për qytetin, pozitive për vendet e punës"*

KORÇE - Turistë të shumtë vizitojnë Korçën çdo ditë. Por ajo që i mbledh bashkë të gjithë është fabrika e birrës së parë shqiptare që mban emrin e këtij qyteti, birra 'Korça'. Këtë radhë qytetin juglindor e kanë përzgjedhur për ta vizituar drejtuesit e agjencive



telegrafike në Europë nga 13 vende të ndryshme. Në këtë tur në qytet ndalesa e tyre e parë ka qenë pikërisht fabrika e birrës 'Korça'. Reporterët europianë kanë parë nga afër procesin e prodhimit të birrës, të cilësuar si më e mira në vend. Historia ...

Në faqen 17

HIMNE PER NDJENJAT

## Njerëz të lënduar e dashuri të pamundura, ja zemërthyerit e "Këngës Magjike"

Suplement

# UNAZA E MADHE
## PROTESTAT

Publicisti Lubonja vesh jelekun portokalli: Çfarë sheh në kodër, prite në votër

# PD, akuza qeverisë: U shemb shtëpia e kushëririt të Havzi Nelës

## "Unaza të bëhet, por banorët të dëmshpërblehen"



Fatos Lubonja, gjatë protestës së djeshme tek Astiri

Valentina Madani

Deputetët e opozitës u shpërndanë dje në tri vatrat e protestës që po zhvillohen njëherësh në Tiranë, në mbrojtje të banesave të tyre, që preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe. Një grup deputetësh ishin dje në zonën e "Astirit", një tjetër në Laprakë dhe deputetë të tjerë, në mbështetje të banorëve të Shkozës. Deputetët apelojnë për dëmshpërblim të banorëve që prekën nga projekti i Unazës së Madhe, ndërsa shprehen se nuk janë kundër ndërtimit të saj. Forcat e IMT-së, Policia Bashkiake dhe forcat "Shqiponja" vendosën që të nxirrnin me forcë një familje nga shtëpia dhe më pas për ta prishur. Sipas PD, familja që ishte vendosur të bëhej shembull e para, ishte ajo e Bajram Nelës. PD akuzoi se banesa e prishur në Laprakë është e një prej të afërmve të poetit të pushkatuar, Havzi Nela. Sipas PD-së, "prishja e banesave në Laprakë nisi me familjen Nela, të afërmin e poetit të pushkatuar Havzi Nela". Sipas demokratëve, institucionet përdorën forcën për të nxjerrë jashtë familjarët e Bajram Nelës. "Familja që ishte vendosur të bëhej shembull e para, ishte ajo e Bajram Nelës. Nisja e prishjeve me forcë të shtëpive me familjen e Bajram Nelës, një i afërm i Havzi Nelës, poetit që u var në 1988 në sheshin qendror të Kukësit nga diktatura komuniste, të kujton jo vetëm firmën e Kristaq Ramës në atë varje, por flet edhe për marrëdhënien që Edi Rama do të vendosë sot me protestuesit", deklaron PD. Sipas saj, për banorët e Unazës së Re, Laprakës, Shkozës dhe shumë zonave të tjera informale, prishja e banesës së Nelëve është një mesazh se me ta nuk do të ketë negociata, por do të flitet vetëm me gjuhën e forcës.

**MBËSHTETJA**

Veç opozitës, përkrah banorëve të "Astirit" mbrëmë ishte dhe Fatos Lubonja, por jo si gazetar dhe analist, por si qytetar. Ai veshi jelekun portokalli, njësoj si protestuesit. Për gazetarët, Lubonja apeloi qytetarët t'i bashkohen kësaj rezistence, pasi siç tha ai, projekti i Unazës së Madhe nuk është një problem vetëm i "Astirit", por një çështje kombëtare. "Kjo nuk është një çështje vetëm e 'Astirit', është një çështje e gjithë shqiptarëve. 'Çfarë sheh në kodër, prite në votër' thotë populli. Kjo që po ndodh këtu është një gjë që ka ndodhur gjithandej dhe së dyti, për të thënë se këtu duhet të jemi të gjithë. Kam ardhur si qytetar për të thënë se këtu duhet të jemi të gjithë, për t'u bërë thirrje të gjithë qytetarëve të Tiranës dhe kujtdo në Shqipëri se kjo është një çështje e të gjithëve. Këta njerëz na japin edhe ne kurajë, ndaj dhe ne duhet t'u japim atyre", tha z.Lubonja. Publicisti apeloi: "Duhet të mposhtim këtë të keqe të madhe që na ka kapur. Po nuk u bashkuam të gjithë bashkë, do të na hanë një nga një. Të bashkohemi të gjithë bashkë edhe te Teatri, edhe në Shkozë, kudo ku ka projekte kriminale. Të mbrohemi për ta rrëzuar këtë qeveri, sepse kjo qeveri po shkon nga krimi në krim në mënyrë galopante". Për indiferencën e qytetarëve të Tiranës dhe mbarë Shqipërisë, Lubonja ka një shpjegim. "Kjo është një punë e gjatë, që është bërë për t'i mpirë njerëzit. Ndaj duhet të rrisim ndjeshmërinë dhe të mbrohemi, sepse do të shkojë shumë larg kjo punë. Ky është vetëm fillimi ndoshta i një të keqeje shumë më të madhe që na pret. Gjithë këta të rinj që janë shpresa jonë duhet të kenë kurajë, të mos kenë frikë, të ndeshen, se kështu fitohet edhe liria, edhe dinjiteti, me përleshje. Kanë rritur vetëm 3 cent benzinën dhe 6 cent naftën dhe po digjet Franca. Detyruan qeverinë të tërhiqet. Kjo është demokracia që kërkojmë. O do bëjmë rezistencë, o do të dorëzohemi dhe ikim". Ndërsa deputeti i PD, Klevis Balliu u shpreh: "Opozita u bën premtim banorëve se do jemi në mbështetje të tyre, sa kohë kauza e tyre mbrohet edhe nga Kushtetuta. Kudo ku ka protesta do të mbështesim çdo protestues që mbështet një kauzë legjitime. Shpreh falënderimin më të thellë për zotin Lubonja dhe për të gjithë ata intelektualë, artistë e gazetarë që janë solidarizuar me protestën. Erion Veliaj kreu sot një pabesi ndaj banorëve të Laprakës, sepse i premtuan mosshembjen, meqenëse e kishte apeluar dhe e shembi të nesërmen. U kuptua se s'mund të kemi besë ndaj kësaj qeverie e kësaj bashkie".

**FATOS LUBONJA**

"Duhet të mposhtim këtë të keqe të madhe që na ka kapur. Po nuk u bashkuam të gjithë bashkë, do të na hanë një nga një. Të bashkohemi të gjithë bashkë edhe te Teatri, edhe në Shkozë, kudo ku ka projekte kriminale. Të mbrohemi për ta rrëzuar këtë qeveri, sepse kjo qeveri po shkon nga krimi në krim në mënyrë galopante", tha z.Lubonja.



Protesta e djeshme në zonën e Astirit

### PD, Shehu: Francezët, dëshmi e popullit që lufton për të drejtat

Deputeti i Partisë Demokratike, Tritan Shehu, vlerësoi dje popullin francez pas protestave të mëdha kundër rritjes së çmimit të karburantit. Në një status në "Facebook", ai shkruan se francezët janë dëshmi e një populli që di të luftojë për të drejtat e tij dhe të fitojë. "Francezët, dëshmi e një populli që di të luftojë për të drejtat e tij dhe të fitojë. Qoftë edhe duke vendosur 'gjotinën' poshtë zyrave të qeverisë... Në fakt, dikur i vendosën realet... Tërhiqet qeveria franceze përballë presionit popullor, duke shpallur moratoriumin për rritjen e taksave të karburanteve, deri në një kompromis me protestuesit. Një popull vital, me koshiencë qytetare, që nuk duron dot padrejtësitë e arrogancën mbi kurriz", - tha deputeti i PD-së.

### Shembja e banesave në Laprakë, Veliaj: Shembull i rrumpallës së fahrinjve





Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj falënderoi dje dy familjet që pranuan të bashkëpunojnë dhe të lirojnë vetë objektet e ndërtuara pa leje, duke i hapur rrugë kështu projektit të ndërtimit të Unazës së Madhe. Nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale bën të ditur se të dyja këto familje pranuan që të pranojnë ofertën e Bashkisë së Tiranës për marrë bonus qiraje deri në tri vite dhe të lirojnë banesat që u prishën sot nga IMT-ja në afërsi të Doganës. "Faleminderit 2 familjeve që vullnetarisht liruan ndërtesat pa leje, pas bonusit të qerasë për t'i hapur rrugë Unazës!", tha Veliaj. Ndërkohë, duke iu referuar rastit të tretë, atij të Bajram Nelajt, Veliaj thekson se ai është demonstrimi më i mirë i të gjithë atyre që duke përfituar nga mungesa e reagimit të institucioneve ka ndërtuar pa leje duke zaptuar prona të të tjerëve. "Rasti 3 i zyrtarit të kthimit të pronave të PD që pasi vodhi pronë e ndërtoi pa leje 4 njësi për t'i dhënë me qira - shembull tipik i rrumpallës së fahrinjve", shkruan Veliaj në "Twitter".





### Strazimiri: Rama i ka shpallur banorët si ilegalë

Deputeti i PD-së, Gent Strazimiri, nga Unaza e Re, deklaroi se protestat e banorëve të Tiranës janë qytetare, por akuzoi se kryeministri Edi Rama se i ka shpallur këta qytetarë si ilegalë. "Në rrugë kanë dalë qytetarët, i ka nxjerrë qeveria. Sot kanë dalë në protestë banorët e Tiranës, njerëz që janë shpallur nga qeveria si banorë ilegalë. Në fakt, kjo është një qeveri ilegale, që nuk zbaton ligjin. Këto janë protesta qytetare, që ne do t'i mbështesim. Ne jemi këtu si qytetarë, jo si politikanë. Është një projekt i paligjshëm, është korruptiv. Shkel çdo të drejtë morale dhe ligjore të Shqipërisë", u shpreh deputeti i PD-së.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Banorët u vënë flakën kazanëve e paralajmërojnë qeverinë: Luftë, nëse na vini sërish

# Tri vatra proteste në Tiranë, në Astir, Bregu i Lumit dhe Shkozë

## Protestuesit, mesazh Metës e Kryemadhit: Na mbështetni



Valentina Madani

Shtëpi që hidhen përdhe, gra që qajnë dhe shtyhen me forcë nga policia, fëmijë të trembur dhe burra që u vihen prangat pas kundërshtive në mbrojtje të banesave të tyre. Tirana u përfshi dje nga tri vatra protestash njëherësh, në Shkozë, në Bregun e Lumit dhe në "Astir", që përshin edhe Laprakën, zona këto që preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe në kryeqytet. Gjatë tri protestave banorët e revoltuar u përplasën me policinë, në mënyrë të veçantë pranë rrotullimit të Doganës në Tiranë. Në vijim të aksionit për shembjen e banesave, forcat e policisë nxorën me forcë banorët që nuk kanë pranuan të dilin nga banesa. Bëhet fjalë për shembjen edhe të një banese 2-katëshe, që preket nga projekti i Unazës së Madhe. Familjaret nuk kanë pranuan të dilin nga banesa dhe kërcënuan se do të ngujohen brenda. "Po më nxirrni në rrugë, kam punuar tërë jetën për këtë shtëpi, si të qetësohem, si ka mundësi që veproni kështu, si ka mundësi që po ndodh kjo?", - tha familjarja mes lotësh, që tentonte të çante kordonin e policisë që të ndalte shembjen.



**SHKOZA**

Policia hasi dje edhe në rezistencën e banorëve të Shkozës, banesat e të cilëve preken nga projekti i Unazës së Madhe. Ata bllokuan rrugët dhe qëndruan si pararojë përballë fadromave. "Ne nuk jemi kundër rrugës, jemi pro rrugës, pro çdo gjëje të mirë, por jo të na nxjerrin në rrugë. Një shtet i mirë e strehon qytetarin e tij. Më ka ardhur fëmija 3 vjeç në shtëpi obobo ma do na prishin shtëpitë. Të kishit qenë sot në orën 5 të mëngjesit, ta kishit parë si e kanë prishur shtëpinë e komshiut. Terror! I kam parë vetë si e kanë ngritur, me copa hekurash. Me gjak, unë qaj për ata fëmijë se i kam parë vetë. I kanë fëmijët moshatarë me të mitë. Kjo nuk është e drejtë", tha një protestuese. Në mbështetje të tyre ishin edhe deputetë të opozitës. "I drejtohem kryeministrit dhe kryetarit të bashkisë. U bënë tri gabime shumë të rënda. Projektin e fute nëpër shtëpi, prishe shtëpitë pa qenë të zotët e shtëpisë aty, sot bërë terrorin më të madh se prishe shtëpinë natën me kalamaj brenda. Hajdeni uluni me popullin, nëse jeni kundër nesh, na thoni. Po na erdhët edhe njëherë si sot, me ne keni luftë, nuk ke më protestë", tha njëri nga banorët.

**BREGU I LUMIT**

Banorët e Bregut të Lumit dolën edhe dje në protestë, ndërsa kërkojnë dëmshpërblimin për shembjen e banesave të tyre. Para kamerave, një prej protestuesve i bëri thirrje presidentit Ilir Meta dhe kryetares së LSI-së, Monika Kryemadhi, që t'i mbështesin banorët. "Desha të çoj tri mesazhe, mesazhi parë për zonjën Kryemadhi, nëse ka marrë votë, të vijë këtu. Mesazhi i dytë shkon për Presidentin. Zoti President, ku je? E shikon popullin si është katandisur në këtë gjendje", tha një protestues. Pronarët e shtëpive paralajmërojnë përshkallëzim të protestave kundër prishjes së banesave deri në bllokim të rrugës. "Tokën e kam blerë me lekë, nuk ka njeri që më merr tokën mua", thotë një tjetër banor. Të hënën IKMT u tërhoq nga plani për shembjen e banesave për shkak të rezistencës së banorëve. Ndërkohë, Partia Demokratike ka shpërndarë një video, sipas së cilës është prishur një banesë e pabanuar. "Të shoqëruar nga forca të shumta policore, u janë afruar shtëpive të banuara. Në video duken fëmijë të traumatizuar, që në vend të shkojnë në shkollë, po qëndrojnë me prindërit në mbrojtje të shtëpive", thuhet në njoftimin e PD-së.

**PROTESTAT**

Tirana u përfshi dje nga tri vatra protestash njëherësh, në Shkozë, në Bregun e Lumit dhe në "Astir" që përshin edhe Laprakën, zona këto që preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe në kryeqytet. Gjatë tri protestave banorët e revoltuar u përplasën me policinë, në mënyrë të veçantë pranë rrotullimit të Doganës në Tiranë.

### Vendimi i qeverisë franceze, Tabaku: Atje reflektuan, këtu një qeveri totalitare

Deputetja dhe nënkryetarja e Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku risolli dje në vëmendje vendimin e qeverisë franceze për pezullimin e rritjes së taksës së karburantit, për të dalë te krahasimi, sipas saj, mes një qeverie demokratike atje dhe një qeverie totalitare në Shqipëri. "Pas javësh të mbushura me përleshje, qeveria franceze ka marrë sot vendimin për të pezulluar rritjen e taksës së karburantit. Ishte kjo taksë që do të rriste çmimin e naftës e për rrjedhojë të gjitha produkteve në Francë. Qeveria dhe vet presidenti Macron reflektuan, duke e pezulluar rritjen që do të niste në janar 2019. Ndryshe nga një qeveri demokratike, kryeministri Rama, që udhëheq një qeveri gati totalitare vazhdon të këmbëngulë dhunshëm në prishjen e shtëpive për interesa oligarkësh. I kapur në ethet e pushtetit absolut, ai ka refuzuar t'i dëgjojë banorët, e le më pastaj të tërhiqet nga veprimi i tij. Kështu veproi edhe me protestën e qytetarëve kundër rritjes së taksës së qarkullimit, që ka çuar në stratosferë çmimin e karburantit. Ky kryeministër njeh për miq dhe aleatë vetëm ata me të cilët ndan paratë publike në tepsinë e pushtetit. Të drejtat e qytetarëve janë të panegocueshme dhe është detyrë e qeverisë që t'i respektojë ato. Shembulli i qeverisë franceze është rasti më i mirë për të dalluar një demokraci nga një rend totalitar", shkruan Tabaku.



### Unaza e Re, ARRSH: Verifikuar 46 objekte të tjera

Autoriteti Rrugor Shqiptar përfundoi mbrëmë procesin e verifikimit dhe matjeve për 46 objekte që preken nga projekti i rehabilitimit të Unazës së Madhe të Tiranës, segmenti Pallati me Shigjeta - sheshi "Shqiponja". Pronarët e këtyre objekteve, të shtrira përgjatë tri loteve të këtij segmenti kishin dorëzuar dosjet e dokumenteve të pronësisë pranë institucionit dhe ARRSH, në respektim të detyrimit ligjor ka kryer verifikimin dhe matjen në funksion të procedurës së shpronësimit. Aktualisht, ARRSH po bën gati dosjet e shpronësimit për këto objekte të para për t'ia përcjellë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë e më tej në Këshillin e Ministrave, ku do të miratohet shpronësimi. ARSH u bën thirrje të gjithë banorëve të objekteve që preken nga projekti i Unazës së Madhe të paraqesin sa më shpejt dokumentacionin e pronësisë për të përfituar pa vonesa nga ajo çka përcakton ligji për rastet e shpronësimit.

### "Zgjidhja, banorët të rrethojnë Kryeministrinë"

## Bumçi: Rama sillet si pushtues, projektin e sjellin të cunguar

Deputeti i PD-së, Aldo Bumçi, iu bashkua dje protestuesve në zonën e Shkozës, në Tiranë. Së bashku me banorët, ata bllokuan qarkullimin si hakmarrje ndaj vendimit të qeverisë për të shkatërruar banesat e tyre. "Të mbrojmë këta familjarë dhe familjet e tyre. Duhet të mbrojmë shtëpitë. Duhet të dalin të gjithë qytetarët dhe të rrethojnë Kryeministrinë, ajo është zgjidhja e vetme. Edi Rama sillet sikur të jetë tërmet dhe jo qeveri", deklaroi z.Bumçi. Duke folur për mediat, Bumçi u shpreh se Edi Rama njeh vetëm një gjuhë, siç bënë kuksianët. "Qytetarë të cilëve u rrezikohet familja, shtëpia që kanë ndërtuar prej 28 vitesh. E para është të mbrojmë këta familjarë dhe familjet tuaja. Dje ishit ju dhe policia nuk arriti që të shkatërronte shtëpitë. Por erdhën në 5 të mëngjesit dhe u shkatërroi banesën, kur nuk kishte asnjë njeri. Edi Rama sillet sikur të jetë pushtues. Lapraka është zona që do të goditet më rëndë. Aty do të shkatërrohen më shumë se 1 mijë shtëpi. E sjellin projektin pjesë- pjesë. Edi Rama nuk njeh asnjë gjuhë tjetër veç forcës, siç bënë kuksianët", deklaroi deputeti demokrat.



## Të arrestuarit e Unazës kërkojnë lirinë në Apel

Daniel Dobraj dhe Dorjan Protoduari, dy prej personave që janë ende në qeli pas protestës së zhvilluar para Kuvendit më 22 nëntor kërkojnë nga gjykata ndryshimin e masës së sigurisë. Për të dy këta persona në ditët e fundit të nëntorit gjykata caktoi masën e sigurisë burg pa afat, por Dobraj, i riu i cili dyshohet se hodhi kapsollën që plagosi punonjësen e policisë Ina Nuku dhe Protoduari, i cili u vu në pranga në ambientet e Spitalit të Traumës, pasi ndaj tij ishte prerë më parë një fletë arresti, kërkojnë lirimin nga qelia ose një masë më të butë sigurie. Kërkesa është bërë nga ana e avokatëve mbrojtës të dy të rinjve.



PROJEKTLIGJET
KOMISIONI

Kreu i ALUIZNI-t ka pohuar se gjysma e tokave në fshat nuk janë të regjistruara

# Shifrat zyrtare, 2.5 milionë prona në Shqipëri janë me probleme

## "Ky është një nga problemet më vrastare"



Kreu i ALUIZNI-t Artan Lame, dje në Komisionin parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese

Afro 2.5 milionë prona në gjithë Shqipërinë kanë probleme me çështjen e pronësisë dhe për rrjedhojë poseduesit e tyre vijojnë të enden nëper sportelet e institucioneve të ndryshme që trajtojnë çështjen e pronësisë në vend. Këtë e pohoi drejtori i ALUIZNI-t, dje në Komisionin parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese ku nisi shqyrtimi i dy projektligjeve të paraqitura nga qeveria, atë "Për kadastrën" dhe atë "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë". Duke bërë një panoramë të situatës së pronave në vend, ai theksoi se nga rreth 4.4 milionë prona që ka në gjithë vendin, rreth gjysma e tyre është me probleme. "Shqipëria rezulton me rreth 4.4 milionë pasuri të paluajtshme nga të cilat rreth 3.8 milionë janë regjistruar dhe janë rreth 600 mijë pasuri të tjera të paregjistruara ende. Në pamje të parë duket sikur është bërë goxha punë dhe është bërë goxha punë. Kur futemi në themel rezulton që rreth 2.5 milionë e pasurive të regjistruara janë me probleme",-tha Lame. Ndonëse nuk hyri në detaje të problematikave më të shpeshta që shoqërojnë këto prona, ai tha se të gjitha ato kanë të paktën nga një veprim për të kryer në institucionet shtetërore ose në rastin më të keq për t'u regjistruar nga e para. "Do të thotë minimalisht duhen axhornuar, përmirësuar, maksimalisht duhen bërë nga fillimi. Shteti shqiptar ka harxhuar rreth 80 milionë euro dhe dollarë në këtë proces deri tani, pra nga '94, të cilat më shumë kanë krijuar kaos sesa kanë zgjidhur punë. 2.5 milionë pasuri janë të deformuara dhe duhen rishikuar. Kjo çon në morinë e pafundme të ligjeve, gjyqeve çka çon në morinë e problemeve, mbivendosje, regjistruar etj",-shtoi Lame. Një nga sektorët ku është mbartur një problematikë e madhe që nuk ka marrë dot zgjidhje sipas tij është edhe kthimi dhe kompensimi i pronës ish-pronarëve. Ai bëri të ditur se aktualisht në Agjencinë e Trajtimit të Pronës mbeten edhe afro 8 mijë praktika të patrajtuara fare. "Nga 47 mijë praktika që ka pasur në të gjithë kohët AKKP-ja, janë marrë deri tani 26 mijë vendime dhe 18 mijë janë rivlerësuar me ligjin e ri. Janë rreth 9 mijë e ca, tani kanë rënë pak, sepse ka vazhduar të punojë Agjencia e Trajtimit të Pronave, mund të jenë rreth 8 mijë në mos gaboj, praktika ende të patrajtuara që nga '93. Le më pastaj të ritrajtuara me ligjin e ri dhe të kompensuara dhe mbyllura përfundimisht",-shtoi kreu i ALUIZNI-t. Një problematikë e mprehtë shoqëron edhe procesin e regjistrimit në ZRPP të tokave bujqësore të shpërndara me ligjin 7501. Sipas tij 50 për qind e pronave të kësaj kategorie janë të paregjistruara. "Kanë përfituar rreth 450 mijë, 438 mijë për saktësi, familje fshatare me procesin e 7501, me ligjin e ndarjes së tokës, nga të cilat rezultojnë rreth gjysma ende të paregjistruara në ZRPP, në kadastër", bëri të ditur Lame. Sipas tij për shkak të kësaj problematike, toka në fshat as mund të shitet dhe as të zhvillohet siç duhet. "Ky është një nga problemet më vrastare të tokës në fshat që bllokon të gjithë proceset e tjera, të shitblerjes, të përfitimit të kredive, incentivave nga Ministria e Bujqësisë e me radhë, për shkak se nuk janë në gjendje të demonstrojnë ligjërisht që janë pronarë të tokës. Veç këtyre janë dhe rreth 20 mijë familje, ka rënë pak për shkak të impenjimit të qeverisë vitin e fundit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë për ta mbyllur si proces, por janë edhe rreth 20 mijë familje që nuk janë pajisur ende me AMTP, pra hallkën e parë për të shkuar më pas te regjistrimi",-shtoi Lame.



Foto ilustruese

**KOMPENSIMI**

"Nga 47 mijë praktika që ka pasur në të gjithë kohët AKKP-ja, janë marrë deri tani 26 mijë vendime dhe 18 mijë janë rivlerësuar me ligjin e ri. Janë rreth 9 mijë e ca, tani kanë rënë pak, sepse ka vazhduar të punojë Agjencia e Trajtimit të Pronave, mund të jenë rreth 8 mijë në mos gaboj, praktika ende të patrajtuara që nga '93"

**AFATET**

Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame nuk ka qenë në gjendje të japë një afat se kur parashikohet të mbyllen proceset e pronës në Shqipëri. Por ai theksoi se i fundit që do mbyllet do jetë ai i kthimit të pronave. Besoj se i pari do të mbyllet procesi i legalizimeve dhe i fundit procesi i kthimit dhe kompensimit të pronës, sepse vetë ligji e parashikon me aktivitet 10 vjeçar",-tha Lame.

### Legalizimet, Lame: Mbarojnë brenda dy vitesh

Kreu i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave dhe ndërtimeve Informale, Artan Lame është shprehur i sigurt se procesi i legalizimeve do të përfundojë brenda 2020. I pranishëm në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, ai ka bërë të ditur se, nëse ecet me ritmin aktual procesi i vështirë i legalizimeve do të mbyllet brenda dy viteve. "Procesi i legalizimeve i filluar në 2004 vijon ende. Tani jemi rreth 165 mijë legalizime në 227 mijë objekte të legalizueshme. Pjesa e mbetur që është rreth 60 mijë do të vazhdojë dhe me këto ritme brenda 2 viteve përfundon procesi i legalizime",- tha Lame. Ndërkohë që në projektligjin e paraqitur në Kuvend, qeveria ka parashikuar që të legalizojë edhe ndërtimet e tjera të ndërtuara deri në fund të vitit 2018, pavarësisht se ligji i mëparshëm parashikonte si afat të fundit ndërtimet e bëra deri në qershor të 2014.

### Meta me homologun zviceran: Vlerësuam marrëdhëniet e mira!

## Presidenti takon Schwarzenegger: Së afërmi do të vijë në Shqipëri



**USHTRIA**

Presidenti Meta uroi dje 106-vjetorin e themelimi të Ushtrisë Shqiptare, ndërsa dha një mesazh për të gjithë ata që mbajnë veshur këtë uniformë. Meta shprehu vlerësim maksimal për kontributin e ushtrisë në operacione humanitare dhe ato paqeruajtëse.

Presidenti Ilir Meta i pranishëm në Samitin e Klimës në Katovicë të Polonisë, ka takuar homologun e tij zviceran, Alain Berset. Kreu i shtetit e cilëson kënaqësi takimin me Berset, ku shprehet se së bashku vlerësuan marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve. "Kënaqësi të vlerësonim me Presidentin e Zvicrës z.Alain Berset, marrëdhëniet e shkëlqyera midis dy vendeve tona, me vullnetin për t'i intensifikuar më tej në të gjitha fushat", shkruan Meta në "Fb". Presidenti takoi dje në Poloni edhe aktorin e madh të filmave aksion Arnold Schwarzenegger. Kreu i Shtetit shpreh kënaqësinë për takimin dhe thotë se Schwarzenegger është mjaft i angazhuar për parandalimin e ngrohjes globale. Por Meta thotë më tej se së afërmi aktori amerikan mund të jetë dhe në Shqipëri. "Kënaqësi të takoja në Katovicë, Arnold Schwarzenegger, mjaft i angazhuar për të ndërgjegjësuar njerëzimin për bashkimin e përpjekjeve për parandalimin e ngrohjes globale para se të jetë vonë. I bindur se së afërmi do ta kemi në Shqipëri",-shkruan Presidenti i Republikës. Kreu i Shtetit po merr pjesë në Samitin e Klimës "COP24" të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që po zhvillohet në Katovicë të Polonisë.

### Rama në Kroaci: Në qershor presim të hapen negociatat

Kryeministri Edi Rama ndodhet në Zagreb të Kroacisë, ku po mbahet Samiti i Kryeministrave të iniciativës së Europës qendrore. Kreu i qeverisë zhvilloi një takim me homologun kroat, Andrej Plenkovi?, ndërsa më pas të dy dolën në një konferencë të përbashkët për mediat. Rama u shpreh se pret nga Brukseli të hapen negociatat me Shqipërinë ne qershor. "Ajo që ne presim nga Brukseli është ajo që meritonim të merrnim që këtë qershor dhe është ajo që kërkon Kroacia dhe shumica e vendeve të BE, pra të hapim negociatat për anëtarësimin",-tha Rama. Ndërsa kryeministri kroat tha se Zagrebi mbështet hapjen e negociatave dhe anëtarësimin e Shqipërisë dhe të Maqedonisë në BE. Ndërsa në lidhje me akuzat e Serbisë për Shqipërinë e Madhe, Rama tha se ai është një term, i cili në Beograd del në dritë sa herë shqiptarët kërkojnë të drejtat e tyre.



MUNGESA

Kreu i ALUIZNI-t ka folur edhe për mungesën e kapaciteteve, madje duke bërë të ditur se ekspertët më të mirë i marrin kompanitë private. "Ne e ndjejmë menjëherë mangësitë e punës sa herë që fillon një investim i ri në Shqipëri. Sa filloi TAP ne ramë menjëherë dhe kishim nevojë për punonjës që nuk na vinin, sepse shkonin te TAP. Sa herë që fillon një aktivitet i madh ekonomik kemi krizë punonjësish",-tha Lame.



## Nisma ligjore, ja pse u përjashtua kthimi i pronave nga Kadastra

Institucioni i ri i Kadastrës Shtetërore do të bashkojë në një funksionet që sot i kryejnë tre institucione të ndryshme. Me konkretisht bëhet fjalë për bashkimin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ALUIZNI dhe Agjencinë e Regjistrimit dhe Transferimit të Pronave. Drejtori i ALUIZNI-t, Artan Lame bëri të ditur se në projektin fillestar të hartimit të këtij ligji ishte parashikuar që pjesë e Kadastrës të bëhej edhe Agjencia e Trajtimit të Pronës, por për të shmangur dyshimet dhe akuzat politike u la jashtë. "Në projektin fillestar ishte edhe Agjencia e Trajtimit të Pronës, por u la për një moment të dytë për një arsye shumë të thjeshtë. Shteti shqiptar është në survejim nga Këshilli i Europës dhe ligji i trajtimit të pronës mezi e kaloi provimin në Strasburg për mënyrën se si ishte hartuar. Ligji në momente të caktuar dukej sikur prekte interesat e pronarëve, por ishte i vetmi real që mund t'u jepte diçka. Pati problemet e veta dhe pati shumë probleme për t'u kaluar në Strasburg. Nëse ne do ta preknim për ta përfshirë këtu do të fillonin dyshimet dhe spekulimet politike. Kështu që, megjithëse unë gjykoj dhe jam i bindur që kjo agjenci të jetë pjesë e këtij ligji, për momentin u gjykua që të mbetet jashtë",-tha Lame.

### Rreth 40 mijë ndërtime të para '91 në gjithë vendin janë të paregjistruara

# Banesat në Shkozë, Lame: Sot marrin certifikatat e pronësisë

## "Stoku i parë i shtëpive të Shkozës që regjistrohen"

Një lajm i mirë për banorët e Shkozës, në mënyrë të veçantë për një pjesë të atyre që preken nga gjurma e Unazës së Madhe. Qeveria ka vendosur të regjistrojë pronat e tyre, çka do u jap mundësi më pas që të futen në procesin e shpronësimit për interes publik. Lajmin e bëri të ditur dje kreu i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave Informale, Artan Lame teksa ka prezantuar dy nismat e fundit ligjore të qeverisë për çështjen e pronave në Shqipëri. Lame theksoi se pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave në korrikun e shkuar nisi puna për regjistrimin e ndërtimeve të bëra në këtë zonë dhe që i përkasin periudhës së para vitit 1991. Ai u shpreh se një pjesë e mirë e banorëve që protestojnë sot në zonën e Shkozës për shkak se preken nga projekti i Unazës përfshihen pikërisht në këtë kategori. Ndaj tha ai duke filluar që nga dita e sotme ALUIZNI do të nisë shpërndarjen e certifikatave të legalizimit të këtyre lloj ndërtimeve. "Në qoftë se sot banorët e Shkozës, një pjesë e tyre janë në protestë, janë në protestë, sepse shteti shqiptar ka qenë i paaftë që nga viti '95 që e ka filluar si proces dhe se përfundoi regji-strimin e shtëpive të Shkozës që regjistrohen. Që do të thotë ka filluar procesi që në korrik me VKM-në që doli dhe u morr me përcaktimin deri tani dhe përfundon regjistrimi i tyre", u shpreh Lame. Ndërkohë ai shpjegoi se marrja e kësaj certifikate i jep këtyre banorëve mundësinë që të kenë të drejtë të përfitojnë nga shpronësimi për interes publik sipas çmimeve që parashikon ligji. "Para disa muaj qeveria miratoi VKM 442 për regjistrimin e banesave para '91. Pjesa më e madhe e banesave të nderuara para '91 janë të paregjistruara në ZRPP gjë që bën të pamundur transferime pronash e me radhë dhe krijon strese të jashtëzakonshme sidomos kur ka shpronësime për interes publik. Ata marrin certifikatën e pronësisë që i bën të mundur pastaj të hyjnë në procesin e shpronësimit për interes publik",-shtoi kreu i ALUIZNI-t. Ai bëri të ditur ndër të tjera se kategoria e ndërtimeve të para vitit 1991 që nuk kanë mundur të regjistrohen në ZRPP përfshinë në total një numër deri në 40 mijë banesa. "Ky stok aktualisht rezulton të jetë rreth 20 deri në 40 mijë familje. Askush nuk e di sa është saktë, sepse është një proces që bëhet me vetdeklarim të qytetarit, por këtu nuk përfshihen vetëm ndërtimet e kohës së Enverit. Mjafton t'ju them që pjesa më e madhe e Gjirokastrës historike është e paregjistruar, pjesë më e madhe e Beratit historik është e paregjistruar", tha më tej Lame. Ai shpjegoi para deputetëve në Komisionin parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese se më i përhapur ky proces është në fshat.



Protesta e djeshme e banorëve të Shkozës

STOKU

"Ky stok aktualisht rezulton të jetë rreth 20 deri në 40 mijë familje. Askush nuk e di sa është saktë, sepse është një proces që bëhet me vetëdeklarim të qytetarit, por këtu nuk përfshihen vetëm ndërtimet e kohës së Enverit. Mjafton t'ju them që pjesa më e madhe e Gjirokastrës historike është e paregjistruar"

### Kreu i ALUIZNI-t paralajmëroi largime nga puna

## Krijimi i Kadastrës do sjellë shkurtim të administratës

Bashkimi i ZRPP-së, ALUIZNI-t dhe Agjencisë së Regjistrimit dhe Transferimit të Pronave do të sjellë automatikisht edhe shkurtim të numrit të punonjësve që sot punojnë në to. Këtë e paralajmëroi dje drejtori i ALUIZNI-t Artan Lame, i cili është dhe një nga bashkë hartuesit e ligjit "Për Kadastrën", i cili do të bëj unifikimin e këtyre tre institucioneve në vetëm një. "Bashkimi i këtyre institucioneve në një dhe i mikroproceseve të tjera që i bashkohen kësaj agjencie natyrisht që do çojë automatikisht në pakësim të personelit. Minimalisht qoftë e gjithë prapavijat e tyre shkurtohen. Nëse sot kemi 4 drejtori personeli do kemi një drejtori personeli. Nëse sot kemi 4 drejtori shërbimesh nesër do kemi një drejtori shërbimesh. Në drejtorin e Përgjithshme do ketë më pak punonjës, për shkak të pakësimit të strukturave të prapavijës. Që në momentin e parë të bashkimit", tha Artan Lame. Por ai theksoi se në të ardhmen numri i të punësuarve të rritet sërish, kjo pasi do t'i jepet më shumë rëndësi verifikimit dhe zgjidhjes së problematikave me pronën në terren dhe çka do kërkoi specialistë të tjerë. "Gjykoj që në të ardhmen për shkak se të gjithë donatorët në vend, përfshi Bankën Botërore, BE, përfshi donatorë të tjerë e kanë shtyrë gjithmonë shtetin shqiptar që t'i hyjë kësaj pune dhe këtyre proceseve dhe janë të gatshme për donacione do jetë e nevojshme të financohen proceset në terren. Pra të heqim dorë nga proceset burokratike në zyra dhe ti japim më shumë rëndësi proceseve në terren",-theksoi Lame. Por i gjithë ky proces mbartet me një rrezik për të gjithë punonjësit që punojnë në këto institucione pasi vendet e punës do të ristrukturohen dhe për rrjedhojë ata do të duhet të konkurrojnë sërish për t'u punësuar. Vetëprojektligji parashikon vetëm 6 muaj kohë punë nga momenti i hyrjes së ligjit në punë.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra permbarimore "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

**Më datë 28 dhjetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00** tek kjo zyrë përmbarimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë "MUSHIQI" shpk të ndodhur në **L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës.** Prona përbëhet nga dy dyqane (gjithsej rreth 245 m2) dhe tre apartamente (gjithsej rreth 245 m2) dhe mbi këto prona nuk rëndon barrë hipotekore apo nuk janë të kufizuara nga detyrime të tjera.

Çmimi fillestar për çdo apartament do të jetë **34.000** lek/m2, ndërsa çmimi fillestar për dyqan do të jetë **51.000** lek/m2.
Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: **052226000** ose cel: **0692075 644**

SHPALLJE ANKANDI

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se më datë 14.12.2018 ora 8 °° - 16 °° ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i I-rë për shitjen e pasurisve të paluajtshme, Truall me sipërfaqe totale 112 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr.pasurie 16/136, Vol.6, Fq.122, ZK.8516 në pronësi të Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.P.K. me vlere fillestare ne ankand 11.648 (Njëmbëdhjet mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) EURO dhe Pasuri e paluajtshme, Truall me sipërfaqe totale 1260 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr.pasurie 16/235, Vol.7, Fq.236, ZK.8516 në pronësi të Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.P.K. me vlere fillestare ne ankand 131.040 (Njëqind e tridhjet e një mijë e dyzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 2/69+2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPËRFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË z. ILMI SULA.

ÇMIMI 5.445.148, 8 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 12.12.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Reagon babai i viktimës në "News 24": Falim gjakun nëse thoni të vërtetën

# Masakra e Mamurrasit me 1 të vrarë e 2 të plagosur, motra e 2 autorëve: Kemi frikë nga hakmarrja

## "Janë të pafajshëm, dënimi absurd. Familjarët e mi kanë marrë arratinë, jetojnë në banesa me qira"

TIRANË

Pas tri vitesh, historia e dy vëllezërve nga Fushë-Kruja, të cilët aktualisht vuajnë dënimin për masakrën e Mamurrasit, ku mbeti një i vrarë dhe u plagosën dy të tjerë u bë dje pjesë e emisionit "Me zemër të hapur" në "News 24". Valbona, motra e Tom dhe Enrik Mamlit, rrëfeu në studio ngjarjen e rëndë dhe pasojat, të cilat po i vuan gjithë familja, ku secili prej tyre jeton me frikën e hakmarrjes çdo ditë. Sipas saj vëllezërit janë të pafajshëm dhe se gjithçka ka ndodhur në kushtet e vetëmbrojtjes. Ajo tregoi se Tomi dhe Enriku përkatësisht 36 dhe 31 vjeç gjenden të izoluar prej tre vitesh, ndërsa i pari është dënuar me 29 vite burg dhe i vogli me 22 vite burg. Ngjarja, për të cilën ata u dënuan ndodhi në qendër të Mamurrasit, më 23 shtator të vitit 2015, ku mbeti i vrarë Naim Tafa dhe u plagosën rastësisht shtetasit: Idriz Tafa dhe Altin Çoku, të cilët gjendeshin, bashkë me shumë persona të tjerë, në zonën e stacionit të trenit. Emisioni u shoqërua me përplasje deklaratash dhe qëndrimesh lidhur me ngjarjen e rëndë. Teksa në studio, motra e dy autorëve të ngjarjes, Tom dhe Enrik Mamli tregonte versionin e saj për krimin, pjesë e emisionit u bë edhe babai i viktimës, Idriz Tafa. Ky i fundit në një lidhje telefonike për emisionin pohoi se familja Mamli gënjen, ndërsa akuzoi dy autorët se ditën e krimit kishin dalë enkas për të vrarë fëmijët e tij. Po ashtu ai tha se pak pas vrasjes së djalit të tij, ai mbeti i plagosur në kokë. Mes të tjerash ai deklaroi se me familjen e autorëve nuk ka punë, ndërsa i kërkoi motrës së tyre që të tregonte të vërtetën dhe pas kësaj do t'ia falte gjakun.

**MOTRA E AUTORËVE**

"Vëllai i vogël, Enriku doli nga shtëpia dhe shkoi në Mamurras dhe la makinën para bashkisë afër një lokali. Aty ndodhej edhe vëllai i madh Tomi, të cilit i ka thënë: 'Më prit sa të marr një dokument dhe erdha, ikim bashkë në shtëpi'. Del Enriku dhe i flet kushëriri, Dorian Mamli 'ndal pak se kam një muhabet'. "Ik" i tha vëllai im se i kemi mbyll muhabetet bashkë, 's'kam për çfarë të flas me ty'. Ai ka insistuar që Enriku të ndalojë, e ka kapur nga krahu dhe më pas janë rrahur me grushte. Pas sherrit me vrap kanë ikur me vëllain tjetër, pasi Enriku i ka thënë: "mos na vij policia hajde ikim, se kam armë me vete". Vëllai i madh s'dinte asgjë", ka thënë në studio motra e Tom dhe Enrik Mamlit. Më pas ajo ka treguar se "në atë moment kur po iknin, një makinë me xhama të zinj e ka goditur mjetin e tyre tek goma e parë dhe kanë shtirë me armë në drejtim të tyre. Toma ka marrë 2 plumba në dorë. Në atë moment, vëllai i vogël ka marrë si fillim automatikun të qëllonte (pasi e kishte në makinë) dhe pasi ai nuk punonte se i është bllokuar ka marrë pistoletën dhe ka gjuajtur. 200 metra më poshtë makina ka ngecur, pasi i ka dalë goma. Nuk ka marrë vesh asgjë se çka ndodhur tek makina tjetër, më vonë nga lajmet janë informuar se një person kishte humbur jetën. Kanë zbritur në këmbë dhe vëllai i vogël erdhi në shtëpi dhe me pas ka lajmëruar policinë se donte të dorëzohej, ndërsa i madhi ka ecur duke kërkuar ndihmë. Ekspertiza e ka treguar qartë se kanë qenë në vetëmbrojtje, dënimi është absurd. Dy vëllezërit e mi të tjerë dhe prindërit jetojnë në arrati, në banesa me qira. Kanë lënë pronën, shtëpinë gjithçka kanë patur. Viktima nuk ka patur asnjë njohje me vëllezërit e mi, pasi ai ka qenë person i inkriminuar, ka bërë burg për disa vepra penale". Ndërkaq, Valbona deklaroi se "pak muaj pas ngjarjes më dolën para dhe më kërcënuan. 'Në qoftë se shkel me në Mamurras do të zhdukim familjarisht". Nuk bëra denoncim nga frika".




**BABAI I VIKTIMËS**

Pas rrëfimit të masakrës së Mamurrasit nga motra e vëllezërve Mamli ka reaguar babai i viktimës, Idriz Tafa, i cili dha versionin e tij.

**Zoti Tafa si ka ndodhur ngjarja?**

Ata kanë dalë qëllimisht që të vrasin fëmijët e mi. Mua më shpëtoi Zoti. Kam ngelur i dëmtuar. Ata kanë ndjekur me makinë. Në 7 sekonda më kanë vrarë djalin. Më pas kanë qëlluar me breshëri me armë. Ata kanë falsifikuar gjithçka, do shkojë në burg edhe prokurori i çështjes. Ato që kanë thënë ata janë duke gënjyer. Më vjen keq për motrën e vet. Ajo nëse është zonjë, burrneshë, të tregojë të vërtetën. Për kokë të fëmijëve unë e fal. Vetëm të tregojë të vërtetën. Djali im ka qenë i dënuar me 4 muaj në Shqipëri dhe ka qenë i pafajshëm. Se di nëse ka qenë i dënuar jashtë.

**A mund t'i shtrini dorën e pajtimit familjes Mamli?**

Për mua jemi paguar nëse tregojnë të vërtetën. I fal nëse thonë të vërtetën. Duke treguar të vërtetën, fiton dhe ligji. Të vijë edhe babai i vet. Se ka qenë dhe ai kur më vranë djalin mua dhe më plagosën mua.

**Ndërhyn motra e dy autorëve:**

Vëllezërit e mi nuk kanë dalë për të vrarë njeri. Vëllezërit e mi, të ndjerin s'e kanë njohur fare. I madhi Zot e sheh të vërtetën, dhe s'ka as ministër e as shtet para tij.

**Idriz Tafa: Unë i kam bërë gjë vëllezërve tuaj? Pse më qëlluan mua?**

Motra: Ke qenë i rastësishëm. Mund të kisha qenë dhe unë aty duke lëvizur dhe mund të isha plagosur.

**Idriz Tafa:** Ata kanë qëlluar me kallashnikov. Ata janë rrahur, nuk janë dëmtuar dhe s'kanë marrë plagë.

### Policia: Ja si ndodhi përplasja mes dy grupeve në Mamurras

Mesditën e 23 shtatorit të vitit 2015, Tom Mamli, Paulin Mamli, Enrik (Elton) Mamli kanë rrahur dhe goditur me sende të forta Dorjan Mamlin, pasi ky i fundit kishte ndërhyrë për të negociuar konfliktin që kishte Enrik Mamli me Edmond Tafën, djalin e xhaxhait të Naim Tafës (viktima). Në atë kohë grupi hetimor tha se konflikti mes tyre kishte nisur në Itali për një borxh prej 250 mijë eurosh që Enrik Mamli kishte pasur ndaj Tafës për hesape prostitucioni. Gjatë sherrit në lokal, i dëmtuar mbeti Dorjan Mamli, i cili ishte qëlluar me grushte e mjete të forta nga kushërinjtë e tij. Kur vëllezërit Mamli po largoheshin me mjetin "Range Rover" me targa AA 481 JT, janë përplasur nga mjeti "Benz" me targa AA 077 CN në të cilin lëviznin Gentjan Elezi, Taulant Bebri (Arjan Tafa) dhe Naim Tafa. Këta persona ishin vënë në dijeni të konfliktit të ndodhur në lokal. Pas përplasjes së automjeteve, personat që ndodheshin në të dyja makinat kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të njëri-tjetrit, ku i vdekur mbeti Naim Tafa, 35 vjeç dhe u plagosën Altin Çoku, 30 vjeç; Idriz Tafa, 59 vjeç; Taulant Bebri (Arjan Tafa), 26 vjeç dhe Besim Xhetani 68 vjeç. Në atë kohë policia raportoi se Elez Tafa, Besim Xhetani dhe Altin Çoku kanë qenë kalimtarë të rastit dhe nuk kanë pasur asnjë lidhje me ngjarjen në fjalë. Pas masakrës, policia arrestoi Enrik Mamlin, Taulant Bebrin (Arjan Tafa) dhe Dorjan Mamlin. Ndërsa, më pas u arrestua Tom Mamli

### "Gjithçka ndodhi për vetëmbrojtje, jemi të pafajshëm"

## Flet nga burgu autori i ngjarjes Tom Mamli: Na qëlluan me armë, vëllai kujtoi se unë kisha vdekur

**TIRANË** - Tom Mamli, i cili akuzohet si një nga autorët e masakrës së Mamurrasit, është bërë dje pjesë e emisionit 'Me zemër të hapur' në 'Neës24'. Mamli, i cili është dënuar me 29 vite burg për ngjarjen, ka mohuar se ka qëlluar me drejtim të viktimës, Naim Tafa. Në një lidhje telefonike nga burgu i Shën Kollit në Lezhë, i riu tha në një intervistë se ai dhe vëllai nuk janë kriminelë dhe se janë të pafajshëm.

**Pse ndodheshit përballë bashkisë ditën kur ndodhi ngjarja?**

Të them të drejtën zonja Evi (Evis) se ne ndodheshim përballë bashkisë, por jemi vërtetë të pafajshëm në këtë histori. Po e nis historinë siç e kam shpjeguar në gjykatë. Atë ditë kam dalë nga shtëpia, si çdo ditë, për të pirë një kafe. Unë e kam shtëpinë në periferi të Mamurrasit, 5-10 minuta zgjat nga qendra. Aty jemi takuar me vëllain, Enerikun, pasi ai kishte dalë të merrte një letër në bashki dhe në ato momente ai ka hyrë në këtë institucion dhe ka dalë prej aty me atë dokument. E kam pritur përballë bashkisë. Jemi takuar sërish. Në ato momente një i fisit tim ka kaluar me makinë aty dhe ne kem pasur një mosmarrëveshje. E kemi ndaluar në rrugë dhe kemi pasur një konfrontim fizik me kushëririn dhe më pas kemi dalë në krahun tjetër të rrugës. Aty ndodhet dhe një lavazh në pronësi të Xhevalin Kecit, kemi marrë makinën dhe jemi drejtuar për të ikur në shtëpi. Në ato momente jemi përballur me makinën e 'Benz' me personat që jemi sot në konflikt. Na kanë goditur me makinë dhe më pas na kanë qëlluar dhe më armë. E kam parë veten me gjak. Kam rënë mbi timon. Në këto kushte vëllai ka pasur disa armë me vete, rastësia na ka shpëtuar. Po mos të kishte pasur ai armë, s'do isha ndoshta duke folur me ju. Se kishim pritur dhe me këta persona. S'u kemi pasur asnjë lloj borxhi.




Pse lëviznit me armë?

Skam pasur armë. kam dalë në Mamurras për të pirë një kafe. Kur i kam parë armë vëllait në makinë, u habita. Kur u konfrontuam me kushëririn, vëllai tha; 'ikim se kam armë me vete'. Enriku i ka pasur rastësisht ato armë. Para një muaj u godit nga disa persona dhe s'e ka ditur se kush janë këto persona.

**Përse e kanë goditur vëllain?**

Zonja Evi, ky është një konflikt i vogël që kemi pasur me disa persona jashtë shtetit.

**Keni pasur grindje me këtë familje?**

Një konflikt e kemi pasur me këtë familje. Që ka nisur jashtë shtetit. Zonja Evi (Evis) këtu janë ngatërruar punët, s'e di si i bën këtë gjë prokuroria.

**Sa persona ishin?**

Ishin 3 persona. Një nga këta persona ka dalë i pafajshëm. Personi i tretë ka ngelur i vrarë atë ditë në vendin e ngjarjes.

**Përplasja e vëllait kur ka ndodhur?**

Ka qenë një incident ku dy nga këta kushërinjtë e palës kundërshtare e kanë goditur Enrikun në Mamurras. E kanë goditur me hunj dhe mjete të forta. Ka përfunduar në spital.

**Ka pasur të dënuar nga ky akt?**

Jo s'ka pasur. Ata e pranuan vet në gjyqin e ngjarjes në fjalë. Babai i viktimës ka ardhur tek shtëpi dhe i ka thënë babait tim që të pajtoheshin. Të gjithë e dinë në Mamurras se ne nuk kemi pasur faj. Në këtë rast Enriku ka pasur armë me vete dhe u kundërpërgjigj, pasi më pa mua të plagosur me gjak dhe kam rënë mbi timon. Dhe ka menduar se unë kisha vdekur. Dhe kjo ka qenë e gjitha. Ne jemi pa faj, ishte vetëmbrojtje.

### Jetojnë me gjyshen invalide, avokati: Të zbutet masa e sigurisë

# Prindërit u arrestuan 9 muaj më parë, 2 fëmijët e mitur shpërthejnë në lot: Na ktheni nënën

**TIRANË** - Që prej 9 muajsh, dy fëmijë të mitur jetojnë me gjyshen e tyre invalide, pasi prindërit e tyre, Leonora dhe Euglen Dushku janë arrestuar në kuadër të një megaoperacioni që goditi 7 grupe kriminale, që dyshohet se kontrabanduan dhjetëra qytetarë drejt Amerikës, Kanadasë dhe Britanisë së Madhe. E ndërsa çifti Dushku mbahet në paraburgim, vajza 10-vjeçare dhe vëllai i saj 5 vjeç jetojnë me gjyshen, e cila është e pamundur për t'u kujdesur për ta. "News 24" foli dje me nxënësen e klasës së pestë, teksa dilte nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, ku ishte bashkë me hallën dhe avokatin për të marrë ndonjë lajm për nënën e babain e saj. Vogëlushja, e cila kërkon të mos i përmendet emri, pasi ka turp nga shokët e shoqet e klasës, në prag të festave të fundvitit ka shprehur vetëm një dëshirë në letrën drejtuar Babagjyshit. "Në shkollë folëm për dhuratat që donim të na sillte Babagjyshi. Të gjithë fëmijët kërkuan dhurata. Ndërsa unë me sytë plot lot, shpreha dëshirën që të kthehen prindërit në shtëpi. Kjo do të ishte dhurata më e bukur për mua e vëllain. Shpresoj shumë të më plotësohet kjo dëshirë, që edhe unë të qesh si çdo fëmijë tjetër", tha vogëlushja. Ndërkaq, avokati Ferid Muça tha se gjykata pa asnjë argument ka rrëzuar pesë kërkesa të paraqitura prej tij për zbutjen e masës së sigurisë, të paktën për nënën e fëmijëve. Sipas tij, drejtësia nuk ka marrë në konsideratë faktin se gjyshja e të miturve është invalide dhe nuk mundet të kujdeset për fëmijët. Ai shpjegoi edhe kushtet e vështira ekonomike ku jetojnë të miturit dhe traumën e madhe që po kalojnë ata. Mbrojtësi ligjor u shpreh se brenda pak ditësh do t'i drejtohet gjykatës me një tjetër kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurisë për bashkëshortët Leonora dhe Euglen Dushku, me shpresën se këtë herë do mundë ta bindë trupën gjykuese që të paktën njëri nga prindërit të shkojë pranë fëmijëve. **kl.ha.**

**"DHURATA"**

"Në shkollë folëm për dhuratat që donim të na sillte Babagjyshi. Të gjithë fëmijët kërkuan dhurata. Ndërsa unë me sytë plot lot, shpreha dëshirën që të kthehen prindërit në shtëpi. Kjo do të ishte dhurata më e bukur për mua e vëllain. Shpresoj shumë të më plotësohet kjo dëshirë që edhe unë të qesh si çdo fëmijë tjetër", tha vogëlushja.



Fëmijët e çiftit Dushku

### Eduard Alushi: Agresorët më morën shumën ditore dhe 30 steka me cigare

# Maskat dhunojnë e grabitin dyqanin, tregtari: Autorët më goditën në kokë

## *"Tre personat që më sulmuan ishin të armatosur, bërtisnin: Na jep lekët, lekët"*



Maskat duke grabitur tregtarin

**TIRANË**

Një grabitje me armë zjarri ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në tregun ushqimor, pranë Qytetit të Nxënësve në Tiranë. Mësohet se tre persona të maskuar me kapuça kanë sulmuar tregtarin Eduard Alushi dhe nën kërcënimin e armëve i kanë marrë lekët e xhiros që kishte në dyqan, si dhe disa steka cigaresh. Ka qenë vetë pronari i biznesit që ka sinjalizuar policinë për rastin, ndërsa kjo e fundit ka shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes. Më pas ai është shoqëruar në komisariat për të dhënë dëshminë e tij. Burime zyrtare nga policia e kryeqytetit bënë me dije se po punohet intensivisht për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Ndërsa, mësohet se janë sekuestruar pamjet e kamerave të sigurisë, ndërsa është marrë në pyetje pronari i dyqanit. "Në zonën e Tregut Ushqimor, persona të paidentifikuar nën kërcënimin e një sendi në dukje si armë, i kanë vjedhur pronarit të një dyqani 30 steka paketash. Po punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve", thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkaq, tregtari Eduard Alushi ka treguar momentet e tmerrit gjatë përballjes me grabitësit. "Tre persona të maskuar mu afruan dhe nisën të më godisnin në kokë.



Vendi ku ndodhi grabitja

Bërtisnin 'lekët, lekët, lekët'. Sapo hynë brenda, ata më drejtuan armën dhe më kërkuan paratë. Nuk munda të lajmëroja policinë. Tentova të marr pultin, por nuk munda. Më shtynë dhe më qëlluan", tha për "News 24" tregtari. Sipas tij, ngjarja ka ndodhur rreth orës 05:30 pranë Qytetit të Nxënësve, ndërsa ai ishte i pari që kishte hapur biznesin në treg. "Kisha vetëm 5 minuta që kisha hapur dyqanin. Kur më thanë 'lekët', u thashë se 'nuk kam'. Më morën 200 mijë lekë që kisha në sirtar për të kthyer kusur dhe 2 kuti me steka cigaresh, gjithsej 80. Më pas u larguan sërish në këmbë në brendësi të tregut. Pasi ikën ata, kam shtypur alarmin dhe policia erdhi për 5 minuta", pohoi Alushi. Pas grabitjes nga maskat, tregtarët u shprehën se ndihen të pasigurt dhe të frikësuar. Ata kërkuan që të merren masa për kapjen e autorëve. "Kemi frikë nga grabitjet. Kjo që i ndodhi kolegut tonë sot, mund të na ndodhë edhe neve. Grabitësit vijnë e ta venë pistoletën në kokë dhe nuk ke çfarë u bën. Policia duhet të marrë masa që ngjarje të tilla të rrezikshme të mos ndodhin më", thanë disa tregtarë.

**RRËFIMI I TREGTARIT**

"Kisha vetëm 5 minuta që kisha hapur dyqanin. Kur tre persona të maskuar mu afruan dhe nisën të më godisnin në kokë. Më thanë 'lekët, lekët', u thashë se 'nuk kam'. Më morën 200 mijë lekë që kisha në sirtar për të kthyer kusur dhe 2 kuti me steka cigaresh, gjithsej 80. Më pas u larguan sërish në këmbë në brendësi të tregut. Pasi ikën ata, kam shtypur alarmin dhe policia erdhi për 5 minuta", pohoi Alushi.


STRATI

Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k.**, njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

**-"Apartament Nr. 37", me sipërfaqe 69,7 m², i ndodhur në katin e pestë, seksioni i dytë të godinës 8 katëshe, në Linzë, Komuna Dajt, Tiranë, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor me Nr. 2099, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale 2460, regjistruar në pronësi të EuroVini sh.p.k.** Çmimi fillestar i ankandit është **19,516 Euro.**
**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 10.12.2018.**

**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR SHOQERUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje 5 copë makina sortimi për nevojat e degëve të Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar shoqeruar me ftesa direkte kandidateve te huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 40,365,000 Lekë ose 323,700 Euro"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerje 5 copë makina sortimi për nevojat e degëve të Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 08 Janar 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.







"Duhet ta bëjmë pagesën vjetore brenda 15 dhjetorit, dallim nga fakultetet e tjera"

# Kreditet për provimet e mbartura me lekë, studentët e Arkitekturës në protestë

## *Bislim Lakna: Nuk tërhiqemi deri në anulimin e vendimit*

Voltiza Duro

Pagesa e krediteve për provimet e mbartura, dhe detyrimi për shlyerjen e tarifës vjetore brenda 15 dhjetorit, i ka hedhur në protestë studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", studenti i Arkitekturës, Bislim Lakna thekson se kërkojnë që të paguajnë tarifën e shkollës në muajin janar, ashtu si gjithë fakultetet e tjera, ndërkohë që shton se për çdo kredit të çdo provimi të mbartur studenti duhet të paguajë 670 lekë. Sipas tij, sipas një VKM-je të majit të vitit 2018, të gjithë studentët që do lënë qoftë edhe vetëm një provim të mbartur duhet të paguajnë edhe një kosto shtesë mbi tarifën. Ditën e djeshme studentët kanë dalë kundër vendimeve të sipërpërmendura dhe kërkojnë me çdo kusht anulimin e tyre. Meqenëse, përgjigjja e zyrtarëve të fakultetit nuk ishte aspak e kënaqshme për studentët, ata sot vendosën që të bllokojnë hyrjet e fakulteteve të Arkitekturës dhe të Inxhinierisë së Ndërtimit. Lakna thotë se nuk do të heqin dorë e do të përshkallëzojnë protestën deri në anulimin e vendimit.

**Pse kanë protestuar ditën e sotme (djeshme) studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës?**

Në dallim nga fakultetet e tjera, ku tarifa paguhet në fund të janarit, në Fakultetin e Arkitekturës e Urbanistikës dhe Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit së fundmi ka dalë një njoftim ku thotë se studentët duhet të paguajnë tarifën e studimit brenda datës 15 dhjetor. Kjo solli reagim të madh tek studentët duke i shtyrë ata të mobilizohen brenda natës për të kundërshtuar këtë vendim. Disa studentë që ishin interesuar në zyrën e financave kuptuan se këtë vit, përveç heqjes së mundësisë së pagesës së tarifës me këste, si pasojë e një VKM-je të majit të vitit 2018, të gjithë studentët që do lënë qoftë edhe vetëm një provim të mbartur duhet të paguajnë edhe një kosto shtesë mbi tarifën, për vlerën e çdo krediti për të gjitha provimet e mbartura. Këto dy probleme iu shtuan kërkesës së parë të studentëve, por doli që problemi i pagesës së krediteve për çdo provim të mbartur, si pasojë e vendimit të VKM-së, prek çdo universitet publik, çdo fakultet dhe rrjedhimisht çdo student, e kjo sipas nesh duhet të anulohet me çdo kusht, qoftë edhe me zaptime e bojkotim të gjithë jetës universitare.

**Sa është masa e parave që duhet të paguani për një kredit për provimet e mbartura?**

Nëse një degë ka tarifën 40.000 lekë, për çdo kredit të çdo provimi të mbartur studenti duhet të paguajë 670 lekë. Pra, në varësi të kostos që ka dega. Deri kur kërkohet shtyrja e afatit të pagesës së tarifës vjetore nga studentët e FAU-t dhe FIN-it kërkohet heqja e menjëhershme e vendimit për të paguar tarifën deri në 15 dhjetor dhe të bëhet pagesa, siç është bërë deri më tani, me këste dhe në fund të semestrit, para sezoneve të provimit.

**Pse është kërkuar pagesa me këste nga ana juaj?**

Në këto kushte, ku tarifat janë të papërballueshme, kostot e jetesës së studentëve janë një barrë që po jua zë frymën shumë familjeve shqiptare, kërkesa për të paguar tarifën me këste është një ndihmesë sado e vogël për xhepin tonë dhe të familjeve tona.

A keni marrë ndonjë përgjigje deri më tani nga instancat përgjegjëse? Duke qenë se përgjigjja e zyrtarëve të fakultetit nuk ishte aspak e kënaqshme, ishte më shumë një orvatje për t'iu shmangur përballjes me kërkesat tona dhe përgjegjësive, atëherë studentët vendosën që nesër (sot) të bllokojnë hyrjet e fakulteteve të Arkitekturës dhe të Inxhinierisë së Ndërtimit.

**Nëse nuk do të gjeni zgjidhje, a do të ketë një përshkallëzim të protestës në ditët në vijim?**

Kërkesa për anulimin e VKM-së në fjalë është diçka me të cilën nuk do bëjmë kompromis. Ne nuk do heqim dorë në asnjë mënyrë dhe me asnjë kusht, pavarësisht se si do të na duhet të veprojmë, deri në anulimin e këtij vendimi, që sipas nesh është vendimi më i dëmshëm që nga miratimi i reformës famëkeqe në arsimin e lartë të vitit 2014.



Protesta e djeshme e studentëve të Arkitekturës dhe Urbanistikës




**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pajisje dhe aksesorë të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,718,400 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerje pajisje dhe aksesorë të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 10 Janar 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## INFERMIERËT NË SHQIPËRI
### PROBLEMATIKAT

Kreu i Shoqatës së Infermierëve: Kërkesat tona kalojnë në heshtje nga ministria

# Eksodi i infermierëve, Jaçaj: Situatë alarmante, pritet përgjysmim i stafit

## "Nuk kemi marrë shpërblimet për fundvit dhe orët jashtë orarit"

Voltiza Duro

*Prej vitesh infermierët nuk po marrin shpërblimin e fundvitit, në një kohë që nuk paguhen për orët shtesë në fundjavë apo në ditë festash. Problematikat ngrihen nga kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, njëkohësisht infermier prej 13 vitesh, Elson Jaçaj, i cili në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" thekson se edhe rritja e pagave ka ngelur vetëm një premtim. Ai shton se fondi i parashikuar për shpërblimet e fundvitit nuk dihet se ku shkon, si dhe më tej bën me dije se Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë dënon ashpër rastet e dhunës ndaj bluzave të bardha. Sipas Jaçaj vendi është përballë një situate alarmante ku shifrat e largimit të infermierëve po rriten e deri në fund të 2019 shumica e spitaleve si shtetërore, private, qendra shëndetësore do jenë përgjysmuar.*



Elson Jaçaj, gjatë një intervistë për "Gazeta Shqiptare"

**EKSODI**

Çdokush do të donte të largohej diku ku në radhë të parë vlerësohet për punën që bën; paguhet siç duhet për punën që bën; punon pa stres e pa presione politike apo dhe pa frikën se kur ndryshon pushteti fillojnë reforma partiake. Ne jemi një profesion që duhet të vlerësohemi për aftësitë profesionale që kemi e jo për ngjyrimin politik.

**A paguhen orët shtesë në fundjavë apo ditët e festave për infermierët që iu duhet të jenë në vendin e punës?**

Orët shtesë, ditët e fundjavës (e shtune a e djelë), ditët e festave apo të fundvitit edhe pse ligjërisht duhet që të paguhen shtesë ose dyfish në të vërtetë infermierëve ju paguhet si ditë normale, pra jo vetëm janë të privuar nga festimi, por dhe nga shpërblimi.

**Keni bërë ndonjë ankesë lidhur me problematikën e sipërpërmendur?**

Është bërë shkresë nga ana jonë drejt ministrisë apo dhe institucioneve përkatëse spitalore, por deri më tani heshtje dhe s'ka asnjë shpjegim pse nuk paguhen kur në kontratën e punës janë të cilësuara.

**A keni marrë ndonjëherë pagën e 13-të, pra shpërblimin e fundvitit?**

Paga e 13 është ironia e çdo viti që luhet me infermierët. Unë kam 13 vite pune dhe mbaj mend që vetëm një herë na është dhënë 10 mijë lekë të reja shpërblim dhe ai tatohej e merrnim nga 9 mijë lekë të vjetra shpërblim. Më pas u harrua çdo gjë, ndërsa tani ka ndryshuar para 2-3 vitesh merrnim nga dy shpërblime: një kartolinë nga ministri i Shëndetësisë dhe një nga Kryeministri ku shprehnin falenderime për punën që ne bëjmë. Vjet ndryshoi, morëm vetëm një shpërblim; kartolinën e kryeministrit me vitin e Skënderbeut. Në fakt, flitet që ky shpërblim jepet për infermierët dhe realisht përveç qëndrave shëndetësore që e kanë prej vitesh asnjë institucion tjetër spital univesitar, bashkiak apo spital rajonal nuk u jep asnjë darkë falenderimi stafit e jo më shpërblim. Se ku shkon fondi që jepet për këtë gjë nuk dihet.

Mund të na tregoni nëse ka pasur rritje pagash për infermierët deri më tani?

Të gjithë e dimë që para pak kohësh, kur u paraqit buxheti për 2019, Ministria e Shëndetësisë dhe kryeministri publikisht thanë që do ketë rritje page për infermierët deri në 20%, gjë që s'ka ndodhur ndonjëherë e jo më larg se para disa ditësh ministria del me një deklaratë tjetër ku thotë se do ketë rritje page për infermierët deri në 7%, e cila nëse miratohet e më pas tatohet është një vlerë e papërfillshme shtesë, pra thjesht një premtim, siç bën çdo pushtet para zgjedhjeve e deri në kohën e miratimit apo hyrjes në fuqi ajo shtesë harrohet. Është e çuditshme pse çdo parti politike bën premtime vetëm në prag zgjedhjesh e më pas nuk bën asgjë ndërkohë që mund të miratohet një ligj me një rritje page për çdo kategori çdo vit dhe pavarësisht kush është në pushtet, ky ligj vihet në zbatim deri sa të ketë një rritje stabël. Tashmë të gjithë jemi mësuar me premtimet politike, por asnjë forcë politike deri më sot s'ka menduar realisht për infermierët e vetëm i kanë përdorur për fushata politike pasi përbëjnë numrin më të madh të punonjësve në shëndetësi.

**Kohët e fundit janë denoncuar raste të dhunës së ushtruar mbi mjekët dhe infermierët. Si e gjykoni ju reagimin e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me këtë?**

Kemi denoncuar raste dhune të ndodhura njëra pas tjetrës brenda pak javësh; një rast ndodhi në reanimacionin qëndror të QSUT, një në Elbasan, një në Fier e të tjera ku nuk deklarohet. Kemi qënë të vetmit që kemi reaguar për këtë gjë e duke i bërë shkresë ministrisë dhe Urdhërit, por fatkeqësisht prej kohësh për të mos thënë prej vitesh ka heshtje nga çdo institucion. Në fakt, deri diku është e kuptueshme heshtja e tyre pasi kanë qënë pikërisht këto institucione që e kanë ushqyer urrejtjen dhe mllefin ndaj personelit shëndetësor e sidomos infermieror. Pra e gjithë kjo jo vetëm prish imazhin e infermierëve, por ushqen dhe një mosbesim dhe urrejtje tek njerëzit. Por thekësoj që asnjë nga deklaratat e tyre nuk janë të vërteta pasi ata gjykojnë nga zyrat e sipas interesave të tyre personale duke abuzuar në kurriz të infermierëve, por harrojnë që janë këta infermierë (që këta shajnë e ofendojnë) që po punojnë me pagat më të ulëta, në kushtet më mizore e po shpëtojnë jetë njerëzish çdo ditë.

**PAGESAT**

> "Orët shtesë, ditët e fundjavës (e shtune a e djelë), ditët e festave apo të fundvitit edhe pse ligjërisht duhet që të paguhen shtesë ose dyfish në të vërtetë infermierëve ju paguhet si ditë normale, pra jo vetëm janë të privuar nga festimi, por dhe nga shpërblimi.

**MASAT**

> "Kemi bërë kërkesë që të ndalohet jo vetëm dhuna ndaj infermierëve, por dhe informimi jo i drejtë i bërë publik në rastet kur deklarohen shkelje të infermierëve apo mjekëve në institucionet ku punojnë".

**Cilat janë masat që duhen marrë për të shmangur këtë fenomen?**

Ne kemi bërë kërkesë që të ndalohet jo vetëm dhuna ndaj infermierëve, por dhe informimi jo i drejtë i bërë publik në rastet kur deklarohen shkelje të infermierëve apo mjekëve në institucionet ku punojnë. Nuk mund të dilet në një përfundim të menjëhershëm apo sapo jepet një lajm të thuhet që fajtor janë mjekët apo infermierët, sikur të ishin kriminelë pasi e kemi parë që ka ndodh rëndomtë e kjo ia prish imazhin e tyre e në fund kanë dalë të pafajshëm. Nuk mund të harrojmë rastin e famshëm në spitalin rajonal të Shkodrës ku u hap proces për mjekët dhe infermierët ku u deklaruan kriminelë për diçka që ata s'e kishin bërë, por ishte faji i ministrisë e në fund u shpallën të pafajshëm. Por a ka vlerë kjo? Ata janë familjarë, u prishet imazhi kudo, u krijon shumë probleme, por është vënë re që çdo punonjës shëndetësor shikohet si vegël pune e pushtetit. Ne kemi kërkuar që të miratohet një ligj i posaçëm për mbrojtjen e personelit shëndetësor në vend dhe të rishikohet dhe gabimi mjekësor, të mos konsiderohet vepër penale pasi jemi i vetmi vend ku më tepër ka çështje gjyqësore me mjekët dhe infermierët se me kriminelët. Kërkojmë edhe sigurim mbrojtje gjatë ushtrimit të profesionit.

**A po vazhdon eksodi i infermierëve drejt Gjermanisë?**

Sigurisht që eksodi i infermierëve jo vetëm vazhdon, por po shtohet, e kjo jo vetëm nga diskrimini që ju bëhet këtu, por dhe nga lehtësimi i procedurave nga vendet e huaja që i kërkojnë e sidomos Gjermania. Kanë lehtësuar dhënien a vizës së punës, madje edhe nivelin e gjuhës e kanë ulur. Në këto kushte çdokush do të donte të largohej diku ku në radhë të parë vlerësohet për punën që bën; paguhet siç duhet për punën që bën; punon pa stres e pa presione politike apo dhe pa frikën se kur ndryshon pushteti fillojnë reforma partiake. Ne jemi një profesion që duhet të vlerësohemi për aftësitë profesionale që kemi e jo për ngjyrimin politik. Pagat është një nga faktorët që ndikon për largimin e infermierëve nga vendi. Ne si shoqatë, pas ca kohësh do dalim në një deklaratë publike me fakte se si është sistemi shëndetësor në vend, sa të vlerësuar e sa të paguar janë infermierët, sa po ikin e sa janë gati për të ikur. Po bëjmë një studim në terren për këtë problem. E kjo për një arsye, pasi ne kemi deklaruar shifra reale të largimeve nga vendi të infermierëve ku UISH i detyruar nga ministria u përpoq t'i përgënjeshtronte ato thjesht për të larguar fokusin nga problematika reale ku është shëndetësia sot e ku janë infermierët sot. Vendi është përballë një situate alarmante ku shifrat që ne kemi deklaruar për largimin e infermierëve jo vetëm që janë të vërteta, por po rriten e deri në fund të 2019 shumica e spitaleve si shtetërore, private, qendra shëndetësore etj do jenë përgjysmuar apo do të kenë më pak se gjysmën e stafit profesionist në punë pasi të gjithë po ikin dhe të rinj ka pak që po punësohen.

Kush nuk e ka dorëzuar, duhet të sjellë llogarinë bankare dhe fotokopje ID

# Kësti i tretë i dëmshpërblimit, emrat dhe dosjet e përfituesve

## *Trashëgimtarët e parë dhe të dytë që marrin paratë*

Ministria e Financave ka publikuar listën emërore të trashëgimtarëve të ish-të përndjekurve politikë të cilët duhet të dorëzojnë numrin e llogarisë bankare dhe një fotokopje karte identetiti ose pasaporte në mënyrë që të marin paratë e dëmshpërblimit. Për ata që kanë një llogari aktive bankare dhe e kanë dorëzuar fotokopjen e mjetit të identifikimit, nuk ka nevojë që ta bëjnë këtë veprim përsëri. "Lista emerore me subjektet perfituese te kestit te trete, te cilet duhen te perditesojne numrat e llogarive bankare dhe fotokopje te mjetitte identifikimit. Trashëgimtarët e nivelit të parë dhe të dytë, të dosjeve të mëposhtëme, të cilët janë në radhë pagese për këstin e tretë, duhet të depozitojnë pranë zyrave tona vërtetimin e numrit AKTIV të llogarisë bankare si edhe fotokopje mjet identifikimi", thuhet në njoftimin e ministrisë së Financave.

### EMRAT ME PERFITUESIT E KESTIT TE TRETE TE PERNDJEKURVE

| Nr. | NR Dosje | VKM | Emer Mbiemer | Tipi Denimit |
|---|---|---|---|---|
| 720 | 4067 | 784 | Njazi Carcani | ME BURG |
| 721 | 4082 | 784 | Riza Resuli | DENIM KAPITAL |
| 722 | 4088 | 784 | Haki Lumi | ME BURG |
| 723 | 4098 | 784 | Petro Serbini | ME BURG |
| 724 | 4099 | 1699 | Fadil Kërniqi | ME BURG |
| 725 | 4100 | 1699 | Mark Doçi | ME BURG |
| 726 | 4111 | 784 | Piro Pilo | ME BURG |
| 727 | 4114 | 707 | Zenel Bardhi | ME BURG |
| 728 | 4120 | 707 | Pashko Shabi | ME BURG |
| 729 | 4128 | 1147 | Ibrahim Selmani | ME BURG |
| 730 | 4130 | 1147 | Reis Shehu | ME BURG |
| 731 | 4132 | 1699 | Xhemal Dokaj(dokanj) | ME BURG |
| 732 | 4133 | 707 | Shaban Gjyzeli | ME BURG |
| 733 | 4134 | 1147 | Kodhel Toska | ME BURG |
| 734 | 4147 | 707 | Sotir Çobaj | ME BURG |
| 735 | 4149 | 1259 | Myslim Iljazi | ME BURG |
| 736 | 4176 | 707 | Mehmet Demneri | ME BURG |
| 737 | 4179 | 784 | Ismail Kolaveri | ME BURG |
| 738 | 4185 | 784 | Abedin Arifi | ME BURG |
| 739 | 4210 | 707 | Daut Vangjeli | ME BURG |
| 740 | 4211 | 1699 | Ahmet Keça | ME BURG |
| 741 | 4215 | 1147 | Xhafer Xhomo | ME BURG |
| 742 | 4220 | 784 | Namik Xhelili | ME BURG |
| 743 | 4223 | 1699 | Dine Kalo | DENIM KAPITAL |
| 744 | 4224 | 707 | Nikoll Kola | ME BURG |
| 745 | 4226 | 1259 | Kolec Kola | ME BURG |
| 746 | 4229 | 707 | Rexhep Çiçi | ME BURG |
| 747 | 4230 | 1699 | Kol Smajlaj | ME BURG |
| 748 | 4233 | 707 | Fran Lazri | ME BURG |
| 749 | 4234 | 784 | Flamur Fusha | ME BURG |
| 750 | 4239 | 707 | Mark Nikolli | ME BURG |
| 751 | 4248 | 1699 | Xheme Prebibaj | ME BURG |
| 752 | 4254 | 1699 | Qemal Sufka | ME BURG |
| 753 | 4258 | 1259 | Gjon Gjivuka | ME BURG |
| 754 | 4269 | 707 | Riza Zoto | ME BURG |
| 755 | 4271 | 1699 | Shyqyri Sharra | ME BURG |
| 756 | 4277 | 784 | Haki Kashari | ME BURG |
| 757 | 4281 | 707 | Izmit Barjami | ME BURG |
| 758 | 4283 | 1699 | Kamber Malezyko | ME BURG |
| 759 | 4286 | 784 | Ibrahim Deliallisi | ME BURG |
| 760 | 4287 | 707 | Zehni Braçi | ME BURG |
| 761 | 4288 | 784 | Lame Llapaj | ME BURG |
| 762 | 4289 | 1699 | Fatbardha Qorri | ME BURG |
| 763 | 4299 | 784 | Dulo Kali | DENIM KAPITAL |
| 764 | 4305 | 784 | Liri Ndreu | DENIM KAPITAL |
| 765 | 4310 | 1231 | Ferik Alibeaj | ME BURG |
| 766 | 4320 | 1699 | Xhevdet Hysa | ME BURG |
| 767 | 4321 | 1699 | Nexhmedin Shehu | ME BURG |
| 768 | 4325 | 1699 | Tefik Hysa | ME BURG |
| 769 | 4334 | 784 | Fiqiret Hoxha | ME BURG |
| 770 | 4337 | 707 | Gjyslyme Leka | ME BURG |
| 771 | 4338 | 707 | Hilmi Leka | DENIM KAPITAL |
| 772 | 4339 | 707 | Enver Hasa | ME BURG |
| 773 | 4346 | 1699 | Taip Haderaj | ME BURG |
| 774 | 4350 | 707 | Mazllem Kaso | ME BURG |
| 775 | 4351 | 1699 | Sali Çako | ME BURG |
| 776 | 4354 | 784 | Hasim Kalasa | ME BURG |
| 777 | 4365 | 784 | Selman Kalleshi | ME BURG |
| 778 | 4371 | 1699 | Haki Tafaj | ME BURG |
| 779 | 4374 | 1699 | Demir Villa | ME BURG |
| 780 | 4377 | 1699 | Enver Hado | ME BURG |
| 781 | 4383 | 784 | Pal Mehillaj | ME BURG |
| 782 | 4385 | 1147 | Hamit Myftiu | DENIM KAPITAL |
| 783 | 4386 | 1147 | Kadri Seitaj | ME BURG |
| 784 | 4388 | 1699 | Demir Thaçi | ME BURG |
| 785 | 4392 | 1699 | Gjon Nikollaj | ME BURG |
| 786 | 4393 | 1147 | Qazim Ferra | ME BURG |
| 787 | 4395 | 1699 | Kajmak Xhilaga | ME BURG |
| 788 | 4396 | 707 | Spiro Tato | ME BURG |
| 789 | 4397 | 1699 | Teki Biçoku | ME BURG |
| 790 | 4398 | 707 | Ibrahim Shyti | ME BURG |
| 791 | 4400 | 1699 | Didin Saliu | ME BURG |
| 792 | 4402 | 784 | Caf Culaj (Hysaj) | ME BURG |
| 793 | 4406 | 707 | Niazi Veli | ME BURG |
| 794 | 4410 | 707 | Ismail Gashi | ME BURG |
| 795 | 4424 | 1699 | Zeqir Zeke | ME BURG |
| 796 | 4425 | 1231 | Gëzim Medolli | ME BURG |
| 797 | 4433 | 707 | Llambro Labo | ME BURG |
| 798 | 4435 | 707 | Nako Labo | ME BURG |
| 799 | 4436 | 784 | Llazi Papa | ME BURG |
| 800 | 4438 | 1699 | Vesel Zogu | DENIM KAPITAL |
| 801 | 4440 | 784 | Mhill Gjini | ME BURG |
| 802 | 4448 | 1699 | Ragip Meta | ME BURG |
| 803 | 4458 | 1699 | Ajas Dushku | ME BURG |
| 804 | 4471 | 784 | Qamil Zotollo | ME BURG |
| 805 | 4493 | 1231 | Myslim Toska | ME BURG |
| 806 | 4512 | 1699 | Gjon Perjaku | ME BURG |
| 807 | 4513 | 784 | Qamil Koreshi | DENIM KAPITAL |
| 808 | 4522 | 784 | Hajdar Dushku | ME BURG |
| 809 | 4524 | 784 | Lluke Gjikoka | ME BURG |
| 810 | 4529 | 784 | Jakup Distani | ME BURG |
| 811 | 4530 | 707 | Gjergj Karaci | ME BURG |
| 812 | 4533 | 1147 | Naun Gila | ME BURG |
| 813 | 4535 | 707 | Sotir haxhi | ME BURG |
| 814 | 4558 | 707 | Vilhelm Mazreku | ME BURG |
| 815 | 4564 | 1699 | Xhuma Shake | ME BURG |
| 816 | 4572 | 707 | Xhevdet Zeqo | ME BURG |
| 817 | 4589 | 784 | Kozma Ziu | ME BURG |
| 818 | 4593 | 784 | Jahja Baçaj | ME BURG |
| 819 | 4596 | 1699 | Ismail Golemi | DENIM KAPITAL |
| 820 | 4597 | 1147 | Fetah Hysa | ME BURG |
| 821 | 4601 | 784 | Iljas Ahmeti | ME BURG |
| 822 | 4606 | 784 | Toli Droboniku | ME BURG |
| 823 | 4613 | 784 | Neki Muçllari | ME BURG |
| 824 | 4617 | 1147 | Avdulla Muhametaj | ME BURG |
| 825 | 4624 | 784 | Sami Kasa | ME BURG |
| 826 | 4628 | 784 | Ndok Ivanaj | ME BURG |
| 827 | 4631 | 784 | Sabri Ymeraj | DENIM KAPITAL |
| 828 | 4635 | 1147 | Mhill Dedaj | ME BURG |
| 829 | 4639 | 784 | Nikoll Xhixhaj | ME BURG |
| 830 | 4645 | 1699 | Ramiz Agushi | ME BURG |
| 831 | 4646 | 1147 | Medin Bego | ME BURG |
| 832 | 4659 | 784 | Xhevat Vehbiu | ME BURG |
| 833 | 4660 | 784 | Skënder Jenisheri | ME BURG |
| 834 | 4662 | 1699 | Mahmut Maci | DENIM KAPITAL |
| 835 | 4664 | 784 | Baftjar Ndreu | ME BURG |
| 836 | 4670 | 1699 | Xhevdet Kapshtica | ME BURG |
| 837 | 4684 | 707 | Hajdar Miraka | ME BURG |
| 838 | 4688 | 1147 | Marash Shabaj (Elezi) | ME BURG |
| 839 | 4689 | 707 | Dodë Qarraj | ME BURG |
| 840 | 4693 | 1699 | Lefi Mena | ME BURG |
| 841 | 4698 | 784 | Mark Marku | ME BURG |
| 842 | 4701 | 1699 | Lazer Locaj | ME BURG |
| 843 | 4702 | 784 | Mustafa Cankja | ME BURG |
| 844 | 4703 | 707 | Gaqo Mosko | ME BURG |
| 845 | 4704 | 1699 | Shuquri Sulo | ME BURG |
| 846 | 4721 | 707 | Qemal Zeka | ME BURG |
| 847 | 4726 | 707 | Zyhdi Duda | ME BURG |
| 848 | 4727 | 1699 | Halil Lazaj | ME BURG |
| 849 | 4743 | 1699 | Lavdosh Sula | ME BURG |
| 850 | 4745 | 1699 | Zija Rexha | ME BURG |
| 851 | 4748 | 1699 | Avni Zhilla | ME BURG |
| 852 | 4761 | 1147 | Drago(dragomir) Vujosheviç(vujosheviq) | ME BURG |
| 853 | 4778 | 707 | Guri Panariti | ME BURG |
| 854 | 4808 | 784 | Beqir Doda | ME BURG |
| 855 | 4814 | 784 | Lavdosh Zami | ME BURG |
| 856 | 4815 | 784 | Hasan Fetahu (Neza) | ME BURG |
| 857 | 4829 | 1699 | Beqir Hoxha | ME BURG |
| 858 | 4838 | 784 | Pal Steaj | ME BURG |
| 859 | 4843 | 707 | Beqir Dibra | ME BURG |
| 860 | 4844 | 707 | Olivera Dibra (Iliq) | ME BURG |
| 861 | 4856 | 784 | Daut Kurti | ME BURG |
| 862 | 4860 | 1147 | Josif Cini | ME BURG |
| 863 | 4864 | 784 | Tom Gazulli | ME BURG |
| 864 | 4865 | 1699 | Dode Zefi | ME BURG |
| 865 | 4885 | 1231 | Masar Mansaku | ME BURG |
| 866 | 4889 | 1699 | Abas Sulaj | ME BURG |
| 867 | 4902 | 784 | Pal Tuci | ME BURG |
| 868 | 4908 | 707 | Adnan Xhuglini | ME BURG |
| 869 | 4909 | 707 | Andon Sheti | ME BURG |
| 870 | 4912 | 707 | Shefqet Kaçaniku | ME BURG |
| 871 | 4916 | 1699 | Niqifor Heqimi | ME BURG |
| 872 | 4921 | 784 | Karafil Isufaj | ME BURG |
| 873 | 4925 | 1699 | Kiço Budo | ME BURG |
| 874 | 4934 | 784 | Syrja Veizaj | DENIM KAPITAL |
| 875 | 4936 | 1699 | Mehmet Sala | ME BURG |
| 876 | 4940 | 784 | Sejfulla Smaci | ME BURG |
| 877 | 4954 | 784 | Mihal Vrano | ME BURG |
| 878 | 4964 | 707 | Dod (Ded) Frroku | ME BURG |
| 879 | 4972 | 707 | Shefqet Hoxha | ME BURG |
| 880 | 4974 | 707 | Gjovalin Prendi | ME BURG |
| 881 | 4984 | 1147 | Ajet Uku | ME BURG |
| 882 | 4988 | 784 | Halil Kupi | ME BURG |
| 883 | 4999 | 1147 | Agim Kodra | ME BURG |
| 884 | 5000 | 784 | Viktor Kujxhija | ME BURG |
| 885 | 5023 | 707 | Mehmet Myrto | ME BURG |
| 886 | 5048 | 707 | Zef Cara | ME BURG |
| 887 | 5051 | 1699 | Hysen Xhepexhiu (Mete) | ME BURG |
| 888 | 5062 | 784 | Nuri Muçollari | ME BURG |
| 889 | 5064 | 784 | Liman(limon) Likrama | ME BURG |
| 890 | 5071 | 784 | Fran Luca(Vukaj) | ME BURG |
| 891 | 5075 | 1699 | Rustem Guma | ME BURG |
| 892 | 5081 | 707 | Myslim Hadri | ME BURG |
| 893 | 5095 | 784 | Andon Sotir | ME BURG |
| 894 | 5097 | 1699 | Filip Sose | ME BURG |
| 895 | 5107 | 1699 | Anastas Hoti | ME BURG |
| 896 | 5108 | 784 | Panajot Baba | ME BURG |
| 897 | 5114 | 1147 | Fotaq Bobi | ME BURG |
| 898 | 5126 | 1699 | Ymet Kreka | ME BURG |
| 899 | 5132 | 784 | Ramiz Çela | ME BURG |
| 900 | 5142 | 1699 | Simon Prifti | ME BURG |
| 901 | 5148 | 1699 | Faredi Angoni | DENIM KAPITAL |
| 902 | 5157 | 1699 | Haxhi Omari | ME BURG |
| 903 | 5160 | 707 | Reis Selfo | DENIM KAPITAL |
| 904 | 5178 | 1699 | Ethem Çelirama | ME BURG |
| 905 | 5181 | 1699 | Kujtim Beqiri | DENIM KAPITAL |
| 906 | 5183 | 1699 | Dod Pergjini | ME BURG |
| 907 | 5197 | 1699 | Rexhep Llozana | ME BURG |
| 908 | 5200 | 707 | Liman Hysenaj | ME BURG |
| 909 | 5201 | 784 | Muharrem Kau | ME BURG |
| 910 | 5202 | 1699 | Tofik Balla | ME BURG |
| 911 | 5209 | 1699 | Kristo Zarkadha | ME BURG |
| 912 | 5217 | 784 | Aristidh Gjini | ME BURG |
| 913 | 5223 | 1699 | Skënder Lulolli | ME BURG |
| 914 | 5233 | 784 | Hysen Velmishi | ME BURG |
| 915 | 5241 | 784 | Ndoc Rama | ME BURG |
| 916 | 5254 | 784 | Haxhi Demiraj | ME BURG |
| 917 | 5270 | 1147 | Fran Nilaj (Shyti) | ME BURG |
| 918 | 5289 | 707 | Zef Lleshi | ME BURG |
| 919 | 5293 | 1699 | Ahmet Hotaj | ME BURG |
| 920 | 5295 | 707 | Neshet Mahmutaj | ME BURG |
| 921 | 5310 | 1699 | Ruzhdi Ibi | ME BURG |
| 922 | 5317 | 1699 | Gani Kasaj | ME BURG |
| 923 | 5319 | 1699 | Abedin Destani | ME BURG |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 924 | 5321 | 707 | Mahir Berberi | ME BURG |
| 925 | 5325 | 1699 | Gjetë Margjini | ME BURG |
| 926 | 5326 | 1147 | Durro Ymeri | ME BURG |
| 927 | 5327 | 1699 | Hasan Shyti | ME BURG |
| 928 | 5335 | 1699 | Shaban Plaka | ME BURG |
| 929 | 5336 | 1699 | Ibrahim Plaka | ME BURG |
| 930 | 5337 | 784 | Qemal Qytyku | ME BURG |
| 931 | 5341 | 1699 | Jani Papa | ME BURG |
| 932 | 5342 | 1231 | Xhemal Nezaj | ME BURG |
| 933 | 5343 | 784 | Teodor Qerimi | ME BURG |
| 934 | 5348 | 1699 | Sheraf Gjebrea | ME BURG |
| 935 | 5355 | 1699 | Nikoll Ndreca | ME BURG |
| 936 | 5356 | 1699 | Pjetër Coku | ME BURG |
| 937 | 5358 | 1699 | Pal Çoku | ME BURG |
| 938 | 5360 | 1699 | Fahri Malushi | ME BURG |
| 939 | 5362 | 1699 | Llesh Toma | ME BURG |
| 940 | 5363 | 1699 | Petro Noto | ME BURG |
| 941 | 5365 | 1699 | Kadri Sinamati | ME BURG |
| 942 | 5367 | 1699 | Pano Priftaj | ME BURG |
| 943 | 5371 | 784 | Fadil Lami | ME BURG |
| 944 | 5402 | 707 | Myslym Rinxhi | ME BURG |
| 945 | 5403 | 784 | Llesh Vata | DENIM KAPITAL |
| 946 | 5408 | 1699 | Riza Hoxha | ME BURG |
| 947 | 5411 | 707 | Ferrik Hysenaj | ME BURG |
| 948 | 5412 | 1699 | Muharem Ahmatas (Selenica) | ME BURG |
| 949 | 5413 | 1699 | Sotiraq Tase | ME BURG |
| 950 | 5414 | 707 | Preng Gjoni | ME BURG |
| 951 | 5415 | 707 | Pashko Gjeçi | ME BURG |
| 952 | 5416 | 784 | Agron Dudushi | ME BURG |
| 953 | 5428 | 707 | Rakip Nerguti | ME BURG |
| 954 | 5432 | 1699 | Sadri Ahmeti | ME BURG |
| 955 | 5433 | 1699 | Ali Ciftja | ME BURG |
| 956 | 5434 | 1147 | Isa Abdija | ME BURG |
| 957 | 5450 | 784 | Sait Çorapi | ME BURG |
| 958 | 5454 | 1699 | Shyqyri Rubiku | ME BURG |
| 959 | 5456 | 784 | Qerim Selmani | ME BURG |
| 960 | 5459 | 1699 | Qazim Haçkovija | ME BURG |
| 961 | 6499 | 1699 | Shahin Zeneli | ME BURG |
| 962 | 6511 | 707 | Ibrahim Murati | ME BURG |
| 963 | 6515 | 784 | Spiro Nakollari | ME BURG |
| 964 | 6517 | 784 | Hajredin Sinaj (Harizaj) | ME BURG |
| 965 | 6522 | 707 | Selman Balla | ME BURG |
| 966 | 6525 | 1699 | Muharrem Poçi | ME BURG |
| 967 | 6527 | 784 | Ymer Shehu | ME BURG |
| 968 | 6529 | 707 | Eqerem Serezi | ME BURG |
| 969 | 6544 | 1231 | Sherif Allamani | ME BURG |
| 970 | 6553 | 784 | Enver Karapiti | ME BURG |
| 971 | 6561 | 707 | Natale Graggiloni | ME BURG |
| 972 | 6562 | 784 | Nesim Spahiu | ME BURG |
| 973 | 6564 | 707 | Qerim Jakupi | ME BURG |
| 974 | 6577 | 1699 | Mualim Rustani | ME BURG |
| 975 | 6600 | 1699 | Bajram Roshi | ME BURG |
| 976 | 6604 | 1699 | Hysen Kënaci | ME BURG |
| 977 | 6609 | 1147 | Themo Muzha | ME BURG |
| 978 | 6614 | 784 | Mahmut Xhafa | ME BURG |
| 979 | 6618 | 1699 | Emrulla Ymeraj | ME BURG |
| 980 | 6621 | 1699 | Mhill Deda | DENIM KAPITAL |
| 981 | 6624 | 1259 | Rexhep Picari | DENIM KAPITAL |
| 982 | 6632 | 1699 | Artan Qirko | ME BURG |
| 983 | 6635 | 784 | Dajlan Zaimaj | ME BURG |
| 984 | 6636 | 784 | Kosta Dhimoleksi | ME BURG |
| 985 | 6647 | 1259 | Sadik Halili | ME BURG |
| 986 | 6656 | 1699 | Sadik Shabaj | ME BURG |
| 987 | 6658 | 784 | Zef Deliaj | ME BURG |
| 988 | 6676 | 784 | Ferit Hajderasi | ME BURG |
| 989 | 6692 | 707 | Ismail Qerimi | ME BURG |
| 990 | 6729 | 784 | Xhemal Haçkovija | ME BURG |
| 991 | 6743 | 707 | Benjamin Ceta | ME BURG |
| 992 | 6757 | 784 | Preng Doci | ME BURG |
| 993 | 6758 | 1147 | Gjon Ndoj | ME BURG |
| 994 | 6760 | 1699 | Gjon Molla | ME BURG |
| 995 | 6763 | 707 | Zef Prela | DENIM KAPITAL |
| 996 | 6776 | 1699 | Mit'hat Araniti | ME BURG |
| 997 | 6786 | 1231 | Xhemal Bardho | ME BURG |
| 998 | 6802 | 784 | Xhelil Ferra | ME BURG |
| 999 | 6806 | 707 | Manush Peshkëpia | ME BURG |
| 1000 | 6813 | 1147 | Prengë Doda | ME BURG |
| 1001 | 6829 | 784 | Luk Vela | ME BURG |
| 1002 | 6831 | 1147 | Pjeter Biba | ME BURG |
| 1003 | 6852 | 1699 | Fetih Selenica | ME BURG |
| 1004 | 6865 | 1699 | Hajdar Kryemadhi | ME BURG |
| 1005 | 6866 | 1259 | Kasem Malasi | ME BURG |
| 1006 | 6870 | 1699 | Kajtas Gaba | ME BURG |
| 1007 | 6872 | 707 | Pjetër Arbnori | ME BURG |
| 1008 | 6873 | 784 | Sotir Dengo | ME BURG |
| 1009 | 6885 | 784 | Hidajet Kulla | DENIM KAPITAL |
| 1010 | 6890 | 707 | Adem Ballçi | ME BURG |
| 1011 | 6896 | 707 | Feti Myftiu | ME BURG |
| 1012 | 6897 | 1699 | Shaban Marjanaku | ME BURG |
| 1013 | 6898 | 784 | Ramazan Spahiu | ME BURG |
| 1014 | 6903 | 784 | Jelena Porobiq (Ndoja) | ME BURG |
| 1015 | 6906 | 707 | Mikel Radovani | ME BURG |
| 1016 | 6918 | 1699 | Ramadan Xeba | DENIM KAPITAL |
| 1017 | 6929 | 1699 | Vatë Vata | ME BURG |
| 1018 | 6950 | 784 | Osman Fazliu | ME BURG |
| 1019 | 6961 | 707 | Theodhoraq Theodhor | ME BURG |
| 1020 | 6962 | 1699 | Thomaq Miti | ME BURG |
| 1021 | 6982 | 1259 | Jovan Mema | ME BURG |
| 1022 | 6997 | 1699 | Zef Murana | ME BURG |
| 1023 | 6999 | 784 | Jak Dedi | ME BURG |
| 1024 | 7012 | 1699 | Ali Zeqo | ME BURG |
| 1025 | 7021 | 784 | Mati Marku | ME BURG |
| 1026 | 7055 | 1699 | Xhavid Sallaku | DENIM KAPITAL |
| 1027 | 7066 | 784 | Sure Ajazi | DENIM KAPITAL |
| 1028 | 7069 | 1699 | Napolon Tasi | ME BURG |
| 1029 | 7072 | 1699 | Dajlan Sadiku | ME BURG |
| 1030 | 7076 | 1699 | Hysni Pollo | ME BURG |
| 1031 | 7088 | 1147 | Shefki Allamani | ME BURG |
| 1032 | 7094 | 784 | Florenc Rusi | ME BURG |
| 1033 | 7098 | 1259 | Muharrem Pistolja | ME BURG |
| 1034 | 7099 | 1699 | Vasil Filipi | ME BURG |
| 1035 | 7100 | 784 | Myrto Hysaj | DENIM KAPITAL |
| 1036 | 7103 | 707 | Sofokli Peri | ME BURG |
| 1037 | 7117 | 1699 | Dedë Volaj | ME BURG |
| 1038 | 7120 | 1699 | Bec Ndrekaj | ME BURG |
| 1039 | 7122 | 1699 | Gjergj Komnino | ME BURG |
| 1040 | 7125 | 1699 | Zafer Villa | ME BURG |
| 1041 | 7127 | 707 | Nexhip Lamçe | DENIM KAPITAL |
| 1042 | 7145 | 1699 | Kostandin Kondili | DENIM KAPITAL |
| 1043 | 7146 | 707 | Hajdar Xhafa | ME BURG |
| 1044 | 7147 | 784 | Bahri Omari | DENIM KAPITAL |
| 1045 | 7163 | 1147 | Ndoc Kola | ME BURG |
| 1046 | 7167 | 707 | Sadik Balaj | ME BURG |
| 1047 | 7168 | 1699 | Shefki Sulkë | ME BURG |
| 1048 | 7172 | 1699 | Veli Biçaku | ME BURG |
| 1049 | 7176 | 707 | Zenel Sinanaj | DENIM KAPITAL |
| 1050 | 7187 | 1699 | Ejup Dajçi | ME BURG |
| 1051 | 7190 | 1147 | Mezan Muhtar | ME BURG |
| 1052 | 7193 | 1699 | Halil Bami | ME BURG |
| 1053 | 7198 | 784 | Abdyl Thaçi | ME BURG |
| 1054 | 7227 | 1699 | George Papas | ME BURG |
| 1055 | 7228 | 707 | Jorgji Zguri | ME BURG |
| 1056 | 7234 | 1699 | Sotir Rusta | ME BURG |
| 1057 | 7239 | 1699 | Ligor Papas | ME BURG |
| 1058 | 7244 | 707 | Preng Lleshi | ME BURG |
| 1059 | 7261 | 707 | Sali Atjani | ME BURG |
| 1060 | 7278 | 1147 | Lazer Sokoli | ME BURG |
| 1061 | 7280 | 1147 | Nikoll Pellumbaj | ME BURG |
| 1062 | 7292 | 784 | Galip Sojli | ME BURG |
| 1063 | 7294 | 1699 | Martin Margilaj | ME BURG |
| 1064 | 7303 | 1699 | Hajri Mane | DENIM KAPITAL |
| 1065 | 7308 | 784 | Stavri Ruvina | ME BURG |
| 1066 | 7315 | 784 | Grigor Llaboviti | DENIM KAPITAL |
| 1067 | 7319 | 1699 | Feim Strataj | ME BURG |
| 1068 | 7337 | 707 | Jonuz Norja | ME BURG |
| 1069 | 7340 | 1699 | Rufan Ndreu | ME BURG |
| 1070 | 7347 | 1699 | Ali Balla | ME BURG |
| 1071 | 7348 | 1259 | Myrjat Dervishi | ME BURG |
| 1072 | 7361 | 1699 | Gjon Pergega | ME BURG |
| 1073 | 7362 | 1699 | Dino (Farodin) Tomori | ME BURG |
| 1074 | 7372 | 1699 | Rexhep Xhika | ME BURG |
| 1075 | 7377 | 1699 | Osman Pepmarku | DENIM KAPITAL |
| 1076 | 7380 | 784 | Pjeter Luka | ME BURG |
| 1077 | 7381 | 784 | Rrok Metaj | ME BURG |
| 1078 | 7385 | 784 | Qazim Zebi | ME BURG |
| 1079 | 7390 | 707 | Vangjel Zaho | ME BURG |
| 1080 | 7393 | 784 | Prend Frroku | ME BURG |
| 1081 | 7395 | 1699 | Gjin Kaçi | DENIM KAPITAL |
| 1082 | 7426 | 1699 | Ivzi Kokalari | ME BURG |
| 1083 | 7429 | 784 | Bexhet Daci | ME BURG |
| 1084 | 7444 | 1699 | Demirsha Qosja | DENIM KAPITAL |
| 1085 | 7445 | 1699 | Koço Gjini | ME BURG |
| 1086 | 7466 | 784 | Gjon Maka | ME BURG |
| 1087 | 7481 | 1699 | Preng Çupi | ME BURG |
| 1088 | 7504 | 1699 | Qerim Gumbardhi | ME BURG |
| 1089 | 7513 | 784 | Atif Merdani | ME BURG |
| 1090 | 7526 | 1699 | Hekuran Zonja | ME BURG |
| 1091 | 7529 | 707 | Xhevat Sejdaras | ME BURG |
| 1092 | 7557 | 784 | Bektash Levenishti | ME BURG |
| 1093 | 7564 | 707 | Bashkim Kina | ME BURG |
| 1094 | 7574 | 1699 | Bardhok Jaku | ME BURG |
| 1095 | 7591 | 1147 | Sabri Cara | ME BURG |
| 1096 | 7606 | 1699 | Anastas Dhami | ME BURG |
| 1097 | 7609 | 707 | Andrea Dhroso | ME BURG |
| 1098 | 7611 | 784 | Dalip Musai | ME BURG |
| 1099 | 7614 | 1147 | Ilia Gjyzeli | DENIM KAPITAL |
| 1100 | 7615 | 784 | Zef Bunjaj | ME BURG |
| 1101 | 7616 | 784 | Miho Marko | ME BURG |
| 1102 | 7632 | 1699 | Prend Përgega | ME BURG |
| 1103 | 7635 | 1699 | Nikolla Skana | ME BURG |
| 1104 | 7637 | 784 | Rebani Kulla | ME BURG |
| 1105 | 7638 | 707 | Selaudin Kulla | ME BURG |
| 1106 | 7639 | 1699 | Uran Kolakula | ME BURG |
| 1107 | 7644 | 784 | Meçan Hoxha | ME BURG |
| 1108 | 7653 | 784 | Sadulla Alushi | ME BURG |
| 1109 | 7656 | 707 | Gëzim Gazheli | ME BURG |
| 1110 | 7658 | 707 | Kol Skeja | ME BURG |
| 1111 | 7661 | 1699 | Abdyl Keçi | ME BURG |
| 1112 | 7678 | 1699 | Seitali Jazxhi | ME BURG |
| 1113 | 7683 | 1699 | Nikoll Ndreca | ME BURG |
| 1114 | 7685 | 1699 | Xhelal Ndreu | ME BURG |
| 1115 | 7690 | 784 | Lazer Brunga | ME BURG |
| 1116 | 7708 | 784 | Hamit Nelku | ME BURG |
| 1117 | 7713 | 707 | Gjelosh Progni | ME BURG |
| 1118 | 7726 | 1699 | Shaban Hoxha | ME BURG |
| 1119 | 7730 | 1699 | Eshref Zajmi | ME BURG |
| 1120 | 7735 | 784 | Sami Çeribashi | DENIM KAPITAL |
| 1121 | 7754 | 1699 | Muharrem Balla | ME BURG |
| 1122 | 7764 | 784 | Ahmet Kazazi | ME BURG |
| 1123 | 7766 | 784 | Lavdije Gruçka | ME BURG |
| 1124 | 7769 | 784 | Vangjel Andriko | ME BURG |
| 1125 | 7771 | 784 | Reiz Lamaj | ME BURG |
| 1126 | 7777 | 1699 | Selami Tirana | ME BURG |
| 1127 | 7793 | 784 | Skënder Hasan | ME BURG |
| 1128 | 7799 | 1699 | Marko Popoviq | ME BURG |
| 1129 | 7819 | 1231 | Pjetër Lulej (Toma) | ME BURG |
| 1130 | 7837 | 784 | Selim Kërluku | ME BURG |
| 1131 | 7841 | 1699 | Et'hem Bakalli | ME BURG |
| 1132 | 7845 | 784 | Halil Halilaj | ME BURG |
| 1133 | 7860 | 1699 | Liman Tanushi(tarushi) | ME BURG |
| 1134 | 7872 | 1147 | Kristo Macango | ME BURG |
| 1135 | 7877 | 1699 | Mexhit Rexha (Ramku) | ME BURG |
| 1136 | 7908 | 784 | Hysenj Plaka | ME BURG |
| 1137 | 7912 | 707 | Tefik Gjini | ME BURG |
| 1138 | 7918 | 1147 | Gjon Çefa | ME BURG |
| 1139 | 7931 | 1699 | Zef Shkoza | ME BURG |
| 1140 | 7938 | 784 | Dodë Ahmataj | ME BURG |
| 1141 | 7950 | 1147 | Shkurt Jaka | ME BURG |
| 1142 | 7951 | 784 | Pal Miri | ME BURG |
| 1143 | 7956 | 1699 | Gjon Hysaj | ME BURG |
| 1144 | 7964 | 1699 | Alush Gjoci | ME BURG |
| 1145 | 7969 | 1699 | Mustafa Spaho | DENIM KAPITAL |
| 1146 | 7971 | 1699 | Qemal Bagllamaja | ME BURG |
| 1147 | 7975 | 707 | Rexhep Tajari | ME BURG |
| 1148 | 7988 | 784 | Fejzi Boriçi | ME BURG |
| 1149 | 7992 | 1699 | Lek Kolaj | ME BURG |
| 1150 | 7994 | 1699 | Bajram Latifi | ME BURG |
| 1151 | 7995 | 784 | Zef Benusi | ME BURG |
| 1152 | 7999 | 1699 | Mersin Piku | ME BURG |
| 1153 | 8003 | 707 | Shefki Hyzeiri | ME BURG |
| 1154 | 8005 | 1699 | Isuf Sala | ME BURG |
| 1155 | 8010 | 707 | Xhemal Lika ( Brahimlika) | ME BURG |
| 1156 | 8011 | 1699 | Zyhdi Çitaku | ME BURG |
| 1157 | 8012 | 784 | Ahmet Agolli | ME BURG |
| 1158 | 8017 | 784 | Dajlan Panariti | ME BURG |
| 1159 | 8021 | 1699 | Manol Kume | ME BURG |
| 1160 | 8058 | 1699 | Hazir Hykaj | ME BURG |
| 1161 | 8060 | 1699 | Qazim Bardhi | ME BURG |
| 1162 | 8062 | 1699 | Ilmi Xhaferaj | ME BURG |
| 1163 | 8074 | 1699 | Javer Hoti | ME BURG |
| 1164 | 8080 | 1699 | Arqile Vreto | ME BURG |
| 1165 | 8098 | 1231 | Emin Bakalli | ME BURG |
| 1166 | 8107 | 1147 | Zef Shkreli | ME BURG |
| 1167 | 8110 | 1699 | Teki Myreslaj | ME BURG |
| 1168 | 8116 | 784 | Tufik Frangu | ME BURG |
| 1169 | 8126 | 1699 | Astrit Kamjeni | ME BURG |
| 1170 | 8133 | 784 | Shuquri Zejnati | DENIM KAPITAL |
| 1171 | 8137 | 707 | Lutfi Fili | ME BURG |
| 1172 | 8148 | 707 | Mihal Dhimojani | ME BURG |
| 1173 | 8155 | 784 | Simo Stefo | ME BURG |
| 1174 | 8156 | 707 | Apostoll Ngjelo | ME BURG |
| 1175 | 8166 | 1699 | Aleko Turtulli | ME BURG |
| 1176 | 8186 | 784 | Gaqo Goreni | ME BURG |
| 1177 | 8217 | 784 | Pjetër Rasha | ME BURG |
| 1178 | 8225 | 707 | Dalip Gaba | ME BURG |
| 1179 | 8236 | 784 | Zenel Buçpapa | ME BURG |
| 1180 | 8237 | 1699 | Halim Xhelo | ME BURG |
| 1181 | 8239 | 1147 | Amir Lama | ME BURG |
| 1182 | 8243 | 1699 | Edi Kapshtica | ME BURG |
| 1183 | 8251 | 1699 | Jorgji Budo | DENIM KAPITAL |

*vijon neser*

Vendimi, pas takimit mes kryeministrit Edouard Philippe e Macron

# Protestat e dhunshme në Francë, tërhiqet qeveria

## *Pezullohet përkohësisht vendimi për rritjen e naftës*

Pas tri javësh protesta të fuqishme kundër rritjes së taksës së karburanteve, qeveria franceze ka bërë hapa pas duke pezulluar kështu vendimin. Shkak u bënë protestat që pushtuan Parisin, ku "jelekët e verdhë" kundërshtuan me forcë rritjen. Mësohet se pezullimi do të jetë vetëm për disa muaj. Vendimi i qeverisë synon të zvogëlojë tensionin dhe të japë kohë për zgjidhjen e ngërçit si dhe nisjen e negociatave me "jelekët e verdhë". Po ashtu, bëhet e ditur se vendimi pro protestuesve erdhi pas një takimi që kryeministri Edouard Philippe zhvilloi në pallatin Elysee me presidentin Emmanuel Macron.

**PROTESTAT**

Ishin mbi 280 mijë veta që protestuan në Paris kundër rritjes së çmimit të naftës. Presidenti francez, Emmanuel Macron dënoi dhunën e demonstruesve, që është ushtruar ndaj policisë dhe institucioneve në protestat e organizuara kundër ngritjes së çmimit të karburanteve. "Le të mbeten me turp ata që sulmuan policinë dhe ata që ishin të dhunshëm ndaj qytetarëve të tjerë. Nuk ka vend për një dhunë të tillë në republikë", shkroi para disa ditësh Macron në "Twitter". Kjo protestë u quajt ndryshe protesta e "jelekëve të verdhëve" dhe ka një arsye për këtë. Në



Francë, shoferët janë të detyruar t'i veshin ato jelekë që konsiderohen si pajisje sigurie. Së bashku me trekëndëshin e kuq që vendoset pas makinës, ata duhet të mbajnë veshur jelekët e verdhë edhe kur dalin nga makina. Në rast se pësojnë problem me automjetin ose aksident dhe nuk kanë të veshur jelekun, ata rrezikohen të gjobiten me 135 euro, bazuar në ligjin e futur në fuqi në vitin 2008.

## Arrestohet zëvendësi i Totorinas, Setimo Mineo

Kreu i ri i sapozgjedhur i 'Cosa Nostra'-s është arrestuar falë një operacioni nga Antimafia italiane. Vdekja e mafiozit të njohur Salvatore Rina bëri që organizata kriminale të kishte një kupolë të re drejtuese, në krye të së cilës ishte 80-vjeçari Setimo Mineo. Prej dekadash ai ishte kapo i klanit Pagliarello në Palermo. Setimo Mineo është nga më të vjetrit në moshë mes bosëve mafiozë të 'Cosa Nostra'-s. Dy vëllezërit e tij janë vrarë në konflikte mafioze dhe ai vetë ka qenë i përshirë në megaprocesin e Palermos, ku u arrestuan mbi 400 bosë mafiozë e ku u dënua me 11 vite burg, dënim të cili e mbaroi në 2006-ën. Hetimet e Antimafias italiane kanë zbardhur se kupola e 'Cosa Nostra'-s është mbledhur më 29 maj të 2018, për të riorganizuar aktivitetin kriminal të trafikut të drogës e basteve 'online', si dhe për të zgjedhur kryebosin e ri. Kjo është hera e parë që kupola e 'Cosa Nostra'-s mblidhet pas takimit të fundit, të mbajtur 25 vite më parë, më 1993. Megaoperacioni çoi në arrestimin e kapos së ri të 'Cosa Nostra'-s si dhe të 46 personave të tjerë me akuzën e pjesëmarrjes në aktivitet të strukturuar mafioz.



# VIP Pages

Suplement

E mërkurë 5 Dhjetor 2018 GAZETA SHQIPTARE

## "BULEVARDI POLITIK"

- Edi Rama harron politikën, luan basketboll në Kosovë
- Kate flet për herë të parë për shtatzëninë e Meghan
- Plagjiaturë? Ministrja: Shpifjet nuk duhet t'ua zënë vendin të vërtetave
- Amarildo Xhindi publikon foton e rrallë nga Kuvendi: Kohë burrash

## Lirohet Stresi? Videoja e tij në një klub nate i habit të gjithë



## Kompozitori habit Bieta Sulon: Do të të puth ty, jo gruan!




Starton edicioni i 20-të, suprizat e mbrëmjes dhe këngëtarët e natës së parë












# Zemërthyera "Kënga Magjike 2018", sa shumë dashuri të pamundura dhe njerëz të lënduar

*Nga Era Rusi te Rozana Radi, ja himnet kushtuar ndjenjave e brengave*

Starton edicioni i 20-të, suprizat e mbrëmjes dhe këngëtarët e natës së parë

# Zemërthyera "Kënga Magjike 2018", sa shumë dashuri të pamundura dhe njerëz të lënduar

*Nga Era Rusi te Rozana Radi, ja himnet kushtuar ndjenjave e brengave*

Pamela Aliaj










Sa shpejt kaloi ky vit dhe tash më kemi arritur në fund të tij, ku edhe nisin festivalet e shumëpritura të këngës, që tashmë janë tradicionale në fundvit. Edicioni i 20-të i festivalit "Kënga Magjike 2018" është pikërisht sot. Për disa të diela me radhë artistët që do të konkurrojnë kanë prezantuar çdo javë projektet e tyre muzikore për publikun në "show"-n e së dielës në "Klan", "E diela Shqiptare". Tashmë datat 5 dhe 6 dhjetor do të jenë netët gjysmëfinale (sot dhe nesër). Ndërsa nata e madhe do të mbahet më 8 dhjetor, ku dhe do të shpallet fituesi i këtij viti të festivalit më të madh të muzikës në Shqipëri. Artistët bashkë me Ardit Gjebrean janë mbledhur tashmë në pallatin e koncerteve për të bërë provat gjenerale në skenën e madhe. Pranë tij në prezantimin e këtij festivali do të jetë dhe balerina bukuroshe Klaudia Pepa dhe moderatorja Bora Zemani. Tashmë prej dy vitesh është bërë traditë që "Kënga Magjike" të ketë dy kategori atë të "New Artist" (Artistët e rinj) si dhe artistët "Big" (që janë të afirmuar tashmë në skenë). Ndërkaq, para disa ditësh janë zbuluar ekskluzive për "Real News" emrat e artistëve, të cilët do të performojnë sot në natën e parë të Këngës Magjike.

**"New artist", fituesit të cilët votohen nga juria me pulsant do kalojnë në natën finale:**

Henri Mahmuti - "Nuk kthehem pas"
All in Band & Lori - "Energji"
Giorgia Igliozzi - "E qui distante" (Është këtu-larg)
Silvi Mema - "Për ty"
Laorjan Ejlli - "Fukara"
Red Carpet - "Jepi kohës kohë"
Amela Agastra - "Më lër"
Eliss - Jemi
Lorenc Hasrama & Olsi Bylyku - "Si të flas"
Genti Deda - "Sa t'kam dasht"
Wendi Mancaku - "Ëndrra ime"
Krusita - "Akull"
Arselinda Sheqeri - "Ndjesë"
Ardit Çuni & Daniela Toçi - "Qaj"

**Nga artistët "Big" janë:**

Era Rusi - "Mos ma merr"
Venera Lumani - "Lind për ty"
Kejsi Tola - "Më ke mua"
Rozana Radi - "Kur përfundon një dashuri si kjo e jona"
Ronela Hajati - "Vuj"
Kastro Zizo - "Sonata e gjumit"
Artjola Toska dhe Bruno - "Digjem"

Siç çdo vit, "Kënga Magjike" do ketë surpriza, pasi në skenë do ketë performanca të trupës së baletit, ku pjesë e saj do jetë dhe Klaudia Pepa, e cila rikthehet si balerinë mbas një kohe të gjatë mungese në skenën shqiptare si dhe të ftuar të tjerë, të cilët nuk janë zbuluar ende. Por përveç gjithë këtyre të rejave, ajo që bie në sy po të dëgjojmë këngët, të cilat konkurrojnë këtë vit është fakti se pothuajse 95% e tyre i dedikohen dashurisë së pamundur. Pra, kjo ndjenjë së cilës i dedikohen kaq shumë balada zemërthyese ka mbërthyer këtë vit edicionin e 20-të të festivalit të këngës. Duke përmendur disa prej tyre shohim se këtë vit pretendohet që kupën mund ta fitojë një këngë e tillë zemërthyese dashurie. Nga klikimet në "Youtube" mund të shohim se një vlerësim të madh i është dhënë këngës së Filloreta Raçit (Fifit të quajtur ndryshe) me Mc Kreshën, "Psikopatja jote". Ndërkaq, në radhë janë shumë artistë të tjerë si Flor Mumajesi me "Plas", apo Ronela Hajati me "Vuj", apo dhe Kejsi Tola me këngën "Më ke mua" apo edhe rikthimi i Rozana Radit me këngën që e kishte rezervuar posaçërisht për "Kënga Magjike", "Kur përfundon një dashuri si kjo e jona". Pra, po të rreshtojmë gjithë këngëtarët e dy netëve të konkurrimit mund të themi pa frikë se baladat kushtuar dashurisë. Pra, çuditërisht këtë vit ka qenë ideja e artistëve për të sjellë në skenë një këngë kushtuar një ndjenje të thyer, të lënduar apo të pamundur. Sot është dhe nata e parë e edicionit, e cila sjell një miks të këngëtarëve të rinj dhe të vjetër në skenë. Të shohim për kë është rezervuar kupa këtë radhë.







Prej disa javësh, këngëtari i njohur Arkimend Lushaj, ose i njohur ndryshe me emrin e tij të artit, Stresi, ndodhet në burg pasi u arrestua në një lokal në zonën e Linzës në kryeqytet, ku u kap me armë pa leje. Por një video e bërë publike në rrjetet sociale nga menaxheri i disa prej këngëtarëve shqiptarë, Xhani Demika, po bën xhiron e uebit, e kjo pas deklaratës së këtij të fundit, ku shprehet se Stresi është i lirë. Në këtë video Xhani shihet duke festuar në një klub nate me këngëtarin e arrestuar, ndërsa bashkangjitur videos shkruan se tashmë ai është i lirë. Ende nuk dihet nëse kjo video është xhiruar 'live' mbrëmjen e djeshme, apo ky është një "provokim" që Xhani bën, duke postuar video të bëra më parë me Stresin. Por nga reagimet e ndjekësve duket se kjo video është jo e vërtetë, duke pasur thjesht synim për të tërhequr vëmendjen e ndjekësve.

# Lirohet Stresi? Videoja e tij në një klub nate i habit të gjithë

Jo rrallë të ftuarit në emisione tërheqin vëmendjen me deklaratat e tyre përpara kamerave, sidomos kur flasim për raste që emisionet janë 'live'. Kësaj radhe është krijuar një situatë pak e sikletshme në emisionin "Ftesë në pesë" i Bieta Sulos. I ftuar në emision ishte kompozitori shumë i njohur dhe i dashur për publikun shqiptar, Agim Krajka. Ai ka rrëfyer për koncertin e ri gala që do të zhvillohet së shpejti, me titullin "Të gjithë e duan Krajkën". Që kur hyri në studio, Krajka nisi të komplimentojë moderatoren e programit, Bieta Sulon, duke i thënë se i kishte vënë kusht produksionit që nëse prezantuesja nuk do të ishte e bukur, ai s'do të merrte pjesë në emision. Gjatë intervistës, Bieta i ka kërkuar Krajkës të përshëndesë e të puthë gruan, mirëpo kompozitori nuk ka pranuar, duke thënë se përderisa e kishte Bietën aq afër, nuk do ta puthte gruan e tij nga ekrani. Krajka është shprehur se në vend të gruas, preferon të puthë Bietën. "Për mua është kënaqësi shumë e madhe që marr gjithë këto komplimente prej teje", - ia ka kthyer Bieta duke qeshur. "Merr të puthurat, lëri komplimentet", - i përgjigjet kompozitori. "Unë do të doja ndonjë kompozim. Po të bëje ndonjë kompozim, ndonjë këngë, po. Kjo është sfida", - ka vazhduar moderatorja. "Do vish të më puthësh ti mua pastaj për kompozimin tim"? "Unë do të falënderoj pastaj". "Epo, falemnderit për faleminderit", - ia ka kthyer Krajka dhe publiku ka qeshur. Situata të tilla nuk kalojnë pa rënë në sy dhe për të ulur pak seriozitetin e të ftuarit, një e qeshur e publikut e zbut më tepër situatën.



# Kompozitori habit Bieta Sulon: Do të të puth ty, jo gruan!

Para pak ditësh këngëtarja e njohur Eneda Tarifa lajmëroi në profilin e saj në "Instagram" se për shkak të impenjimeve personale, nuk mund të ishte këtë vit pjesë e jurisë së "The Voice Kids". Pasi u uroi suksese miqve të saj të jurisë, Eneda e la të hapur vendin për një tjetër këngëtare të suksesshme. Por sipas "Anabel.al", Arilena Ara do të jetë pjesëtarja e re e jurisë në "The Voice Kids". Megjithëse e re në moshë, ajo ka treguar talent të madh duke korrur sukses të jashtëzakonshëm dhe tashmë, dijet dhe vlerësimet e saj për muzikën do t'i ndajë me fëmijët e vegjël konkurrentë. Të shohim në netët 'live' se kush do të jetë vërtetë në poltronën e Tarifës.





# Largohet Eneda Tarifa nga "The voice kids", ja kush do e zëvendësojë



Edhe pse nuk e kanë pranuar me foto apo me fjalë, ndonjëherë dhe komentet luajnë rolin e tyre në lidhjet e VIP-ave ditët e sotme. Këtaj radhe i referohemi lidhjes së Feros me Arbenitën, të cilët tashmë nuk po fshihen. Reperi ditë më parë i bëri një dedikim Arbenitës në njërën nga fotografitë e publikuara, duke shkruar: "I gjithë universi në një foto". Por, ngacmimet vazhdojnë ende nga dyja palët, pasi së fundmi është modelja, ajo që i ka shkruar Feros, duke i komentuar syzet që ai i kishte vënë e që si duket janë të saj. E nuk ka munguar as përgjigjja e Feros, i cili është shprehur se do ia kthente.

# Nuk e fshehin më lidhjen! Modelja s'duron dot pa i komentuar reperit në foto

Këshilla





*Ankthi është pjesë e jetës sonë dhe funksioni i tij mund të krahasohet me atë të tensionit të gjakut. Ne na duhet një nivel i caktuar i tij që të jetojmë, por nëse ky nivel rritet shumë, atëherë mund të na dëmtojë.*

Dr. Enila Cenko
Psikologe

# Vuani nga ankthi? Ja si të çliroheni prej tij

Të gjithë përjetojmë ankth në momente të caktuara të jetës, sidomos në çaste kritike, si rrugës për një intervistë pune, përpara provimeve apo kur do takojmë një person të ri. Ankthi është pjesë e jetës sonë dhe funksioni i tij mund të krahasohet me atë të tensionit të gjakut - ne na duhet një nivel i caktuar i tij që të jetojmë, por nëse ky nivel ngrihet shumë, atëherë mund të na dëmtojë. Pra, një nivel i caktuar ankthi është i dobishëm, sepse na shtyn që të veprojmë, të marrim vendime dhe të zgjidhim problemet tona. Por, në rastin kur ankthi bëhet pjesë e pandashme e jetës sonë, atëherë ai kthehet vetë në një problem. Njerëzit që vuajnë nga ankthi kronik shpenzojnë një pjesë të mirë të ditës, duke u shqetësuar dhe u frikësuar për çfarë mund të ndodhë në të ardhmen. Ankthi kronik është paralizues, na detyron të harxhojmë shumë energji emocionale dhe ndërhyn në aktivitetet tona të përditshme, duke na bërë të ndihemi të lodhur fizikisht dhe të ngarkuar psikologjikisht. Lajmi i mirë për të gjithë ata që bashkëjetojnë me ankthin është që çdokush mund të mësojë të menaxhojë ankthin nëpërmjet teknikave të ndryshme, disa prej të cilave do të trajtohen në vijim. Këto teknika mund të përdoren nga kushdo për të mbajtur në kontroll simptomat e ankthit dhe për t'u ndjerë më mirë. Duhet theksuar se në rastet e nivelit të lartë të ankthit, ndihma e psikologut apo psikoterapistit është e nevojshme.



**Mësoni të bashkëjetoni me ndjenjën e pasigurisë**

Personat që vuajnë nga ankthi kërkojnë në mënyrë të vazhdueshme siguri të plotë për çfarë do të ndodhë në të ardhmen. Ata shqetësohen gjatë gjithë kohës për çfarë mund të ketë ndodhur apo çfarë do ndodhë. Për më tepër, ata përqendrohen kryesisht tek skenarët negativë të së ardhmes. Shpeshherë ky shqetësim i vazhdueshëm perceptohet si një mënyrë e të qenit në kontroll dhe e bën dikë të ndihet më i sigurt për të ardhmen. E vërteta është që sado që të vrisni mendjen për çka mund të sjellë e ardhmja, përsëri nuk mund ta bëni jetën më të parashikueshme. Dikush mund të ndihet më i sigurt ndërsa shqetësohet për të ardhmen, por në fakt ky efekt është vetëm një iluzion. Nuk është se mund të parandaloni ngjarje negative thjesht duke menduar për to. Përkundrazi, duke u përqendruar në mendime negative për të ardhmen, të cilat mund të mos realizohen kurrë, nuk shijoni dot të sotmen së bashku me të gjithë gëzimet e saj. Është e nevojshme për të ulur nivelet e ankthit që të filloni të punoni dhe të ndryshoni nevojën për siguri dhe për të parashikuar të ardhmen. Mos i lejoni ankthit të zaptojë të gjitha orët e ditës suaj. Nëse u dedikoni një pjesë të mirë të ditës mendimeve ankthioze, atëherë është shumë e vështirë që të jeni produktivë dhe të funksiononi shëndetshëm. Por dhe të përpiqeni që t'i zhdukni këto mendime plotësisht nuk funksionon - të paktën, jo për shumë kohë pasi ato kthehen përsëri, nganjëherë dhe më të forta se më parë. Kjo nuk do të thotë që nuk mund të bëni asgjë për të kontrolluar ankthin. Por në vend që të përpiqeni t'i zhdukni këto mendime plotësisht, mund të jetë më e suksesshme që të mësoni se si të krijoni një hapësirë kohore të caktuar për to. Për të arritur këtë qëllim, caktoni një orar dhe një vend për t'ia dedikuar ankthit (le të themi 6:00-6:20 në dhomën e gjumit). Ky orar dhe vend është mirë të jenë të njëjtët çdo ditë. Gjithashtu sigurohuni që orari nuk është afër orarit të gjumit se përndryshe mund të keni probleme me gjumin. Thojini vetes që vetëm gjatë këtij orari jeni të lejuar të mendoni për gjëra që ju shkaktojnë ankth, ndërsa në pjesën tjetër të ditës nuk do e lejoni ankthit t'ju zaptojë. Nëse gjatë ditës ju vjen në mendje një mendim që ju shkakton ankth, mbajeni shënim dhe thojini vetes që do i riktheheni gjatë orarit të caktuar. Gjatë këtij orari shpenzoni kohë duke menduar për mendimet që keni shkruar gjatë ditës, por mos ju ktheni më gjatë ditës. Kjo teknikë ju lejon që të shmangni përjetimin e ankthit në çdo moment dhe ju jep një ndjenjë të fortë kontrolli mbi emocionet tuaja. Me kalimin e kohës do vini re që do filloni të shkurtoni orarin e caktuar, derisa ta zhdukni atë fare nga dita juaj.

**Mësoni si të qetësoheni dhe relaksoheni**

Ankthi nuk është vetëm psikologjik, por shkaktohet dhe shoqërohet dhe me reagime fiziologjike. Kur përjetoni ankth zemra ju rreh fort, frymëmarrja shpeshtohet, muskujt tensionohen dhe duart ju djersiten. Ndërsa kur jeni të relaksuar ndodh komplet e kundërta. Rrahjet e zemrës janë më të ngadalta, frymëmarrja është e thellë dhe muskujt janë të shtensionuar. Nëse arrini të relaksoni trupin në momentet që përjetoni ankth, atëherë edhe mendja do të çlirohet. Teknika të ndryshme mund të përdoren për të arritur këtë qëllim, duke përfshirë këtu relaksimin progresiv të muskujve, frymëmarrjen e thellë dhe jogën ose meditimin. Relaksimi progresiv i muskujve përfshin tensionimin sistematik të grupeve të muskujve në trup dhe më pas relaksimin e tyre, ndërsa frymëmarrja e thellë është një teknikë relaksimi që konsiston në marrjen frymë nga diafragma. Për t'i përvetësuar sa më mirë këto teknika, është mirë të fillohet me 30 minuta ushtrime relaksimi çdo ditë. Me kalimin e kohës, këto teknika bëhen të natyrshme dhe aftësia për t'u relaksuar gjatë përjetimit të ankthit rritet.

**Kujdesuni për veten**

Një stil jetese i balancuar dhe i shëndetshëm gjithashtu ndihmon në menaxhimin e ankthit dhe simptomave të tij. Është e rëndësishme që të ushqeheni në mënyrë të shëndetshme, duke ngrënë vakte të shpeshta, por të vogla në sasi gjatë ditës. Nëse rrini pa ngrënë për një kohë të gjatë, bie niveli i sheqerit në gjak, gjë që mund t'ju sjellë ankth dhe gjendje të irrituar. Dieta duhet të përfshijë karbohidrate të ndryshme nga drithërat, frutat dhe perimet. Këto karbohidrate jo vetëm stabilizojnë nivelin e sheqerit në gjak, por edhe ngrenë nivelet e serotoninës, një kimikati në tru që ka efekte qetësuese. Evitoni pijet me kafeinë si dhe nikotinën, pasi të dyja këto lëndë stimulojnë sistemin nervor dhe rrisin efektet e ankthit. Ndërkohë përpiqumi të kryeni të paktën 30 minuta aktivitet fizik 2 ose 3 ditë në javë. Aktiviteti fizik ju ndihmon që largoni stresin, të merrni energji dhe ndihmon në mirëqenien psikologjike pasi gjatë stërvitjes çlirohen endorfina, kimikate si adrenalina që na bëjnë të ndihemi mirë. Mungesa e gjumit mund të jetë gjithashtu një faktor që sjell ankth gjatë ditës, prandaj kujdesuni që të plotësoni orët e gjumit që ju nevojiten.

BIRRA KORÇA
VIZITA





### Drejtuesit e agjencive të lajmeve të 13 vendeve europianë vizitojnë fabrikën

# Reporterët europianë vizitojnë birrën "Korça": Shije e veçantë

## *Bionde apo e zezë, gotat plot sipas preferencave*

KORÇE

Turistë të shumtë vizitojnë Korçën çdo ditë. Por ajo që i mbledh bashkë të gjithë është fabrika e birrës së parë shqiptare që mban emrin e këtij qyteti, birra 'Korça'. Këtë radhë qytetin juglindor e kanë përzgjedhur për ta vizituar drejtuesit e agjencive telegrafike në Europë nga 13 vende të ndryshme. Në këtë tur në qytet ndalesa e tyre e parë ka qenë pikërisht fabrika e birrës 'Korça'.

Reporterët europianë kanë parë nga afër procesin e prodhimit të birrës, të cilësuar si më e mira në vend. Historia, infrastruktura, investimet, arredimi, kujdesi në detaj për çdo hap të punës në këtë fabrikë kanë lënë mbresat më të mira tek ta.

Por ajo që i ka tunduar më shumë ka qenë vetë pija në të gjitha ngjyrat e saj e sapo prodhuar në fabrikë. Dhe siç e do zakoni gotat me birrën 'Korça' janë mbushur plot sipas preferencave për të bërë edhe një gëzuar duke krijuar kështu edhe me atmosferën në sfond një pikturë turistike të vendeve të Europës të mbledhur në një.

E kanë çmuar shumë këtë moment reporterët europianë, të cilët nuk kanë ngurruar të japin edhe sugjerime për eksportin e birrës 'Korça' në vendet e tyre.

"Provova birrën bionde, ishte shumë e mirë. Vij nga Ukraina ku ka shumë birra, por kjo fabrikë është shumë e mirë, më pëlqen birra këtu. Ishte interesante historia e fabrikës së birrës së parë në Shqipëri. Kjo fabrikë mendoj se duhet të jetë një model shumë i mirë për bizneset shqiptare"- thotë Natalia Kostina nga Ukraina.

Sakaq George Pennintaexs nga Qipro shprehet: "Vij nga Qiproja, është hera e parë që vij në Korçë. Pata rastin që të provoj për herë të parë birrën 'Korça', është shumë e mirë. Kjo fabrikë është një aset për këtë qytet, diçka pozitive për vendet e punës. Kjo birrë që ka një shpërndarje rajonale, shpresoj të vijë edhe në vende më të largëta, si ne Qipro. Jemi shumë të kënaqur, do dëshiroja të kisha disa tapa birre pasi vajza ime është koleksioniste e tapave të shisheve të birrës".



**IMPRESIONET**

"Pata rastin që të provoj për herë të parë birrën 'Korça', është shumë e mirë. Kjo fabrikë është një aset për këtë qytet, diçka pozitive për vendet e punës",-thotë George Pennintaexs nga Qipro.

"Jam shumë e kënaqur që jam në Korçë dhe faleminderit për mikpritjen këtu. Korça më ka pëlqyer shumë, ka ngjashmëri me qytete rumune. Kjo fabrikë me pëlqeu shumë. Provova birrën e zezë dhe ishte shumë e shijshme, me një shije të veçantë, të ëmbël"- thotë Claudia Nicolae nga Rumania.

Vizita e drejtorëve të agjencive telegrafike të Europës u përmbush më tej në restorantin e fabrikës me shijet e ushqimeve tradicionale të Korçës.




ARKEOLOGJI

# Ambasadori austriak sjell në Apoloni stelën e zhdukur gjatë luftës

Fatmira Nikolli



Një stelë varri me motive flo rale, "është kthyer" në Sh qipëri 100 vite pasi u zhduk. Origjinali i saj ruhet në Muzuen e Vjenës, ndërsa në Apoloni është dorëzuar një kopje e saj nga ambasadori Johann Sattler. Njoftimi zyrtar i Parkut Arkeologjik Kombëtar të Apolonisë, thotë se Instituti Arkeologjik i Vjenës dhe ambasada austriake në Tiranë i dhuruan Muzeut Arkeologjik Apoloni MAA, kopjen e një stele funerare e cila gjendet në Muzeun Arkeologjik të Vjenës". Dhurimi erdhi në kuadër të ekspozitës dhe konferencës, "100 vjet gërmime arkeologjike në Shqipëri. Prezenca austro-hungareze në arkeologjinë shqiptare", edhe kjo bashkëpunim mes Ambasadës Austriake në Tiranë, Institutit Shqiptar të Arkeologjisë dhe Muzeut Historik Kombëtar. Qëllimi qe të kujtohej kontributi i misioneve austro-hungareze në arkeologjinë shqiptare, duke dhënë një panoramë të përgjithshme të rrugëtimit të tyre shkencor, që zbuluan dhe dokumentuan mjaft të dhëna arkeologjike për qytete të ndryshme antike të Shqipërisë. Të dhënat më të hershme të kërkimeve austriake rreth pasurive arkeologjike të vendit tonë vijnë nga arkeologu Karl Paç, i cili në fakt mbyll edhe serinë e udhëtarëve arkeologë në fillim të shek. XX. Ekspozita u realizua me ndihmën e Sabine Ladstatter dhe Alexander Sokolevic nga Instituti Arkeologjik Austriak në bashkëpunim dhe me arkeologët e profesorët shqiptarë si Neritan Ceka, Luan Përzhita dhe Bashkim Lahi.

*Vjen nga Muzeu i Vjenës kopja e objektit, e dorëzon Johann Sattler*

Konferenca u hap me përshëndetjet e drejtorit të Muzeut Historik Kombëtar Dr.Dorian Koçi dhe ambasadorit të Austrisë në Tiranë, Johann Sattler, të cilët theksuan se studimet arkeologjike në Shqipëri përjetuan një etapë të re gjatë viteve 1916-1918, ku Akademia e Shkencave të Vjenës në bashkëpunim me komandën e trupave austro- hungareze, të cilat kishin pushtuar pjesën më të madhe të territorit tonë, organizuan ekspedita informative me qëllimin identifikimin dhe grumbullimin e objekteve të ndryshme arkeologjike dhe si rrjedhojë duke realizuar një vlerësim paraprak mbi pasurinë arkeologjike të Shqipërisë, si dhe fazat historike të këtij territori. Një pjesë e këtyre objekteve arkeologjike, të identifikuara prej arkeologëve austriakë janë përfshirë si pjesë e ekspozitës arkeologjike të përhershme në katin e parë të Muzeut Historik Kombëtar, ku veçojmë mozaikun e ashtuquajtur "Bukuroshja e Durrësit", ndër punimet e para të artit muziv të dëshmuar në territorin tonë, të datuar në fund të shek. IV - fillimi i shek. III p. Kr., zbulimi i saj në vitin 1958, u realizua pikërisht falë njoftimeve të shënuara më parë nga Prashniker; një objekt tjetër i ekspozuar në muze, identifikuar nga Prashniker e Shober, është stela e varrit e njohur si e Falakrës dhe Neagenës, datuar në fund të shek. III - fillimi i shek. II p. Kr.; po ashtu, një gjetje mjaft interesante përbën edhe portreti prej mermeri i perëndisë Silen, identifikuar fillimisht nga arkeologu austriak K. Paç, në muret e manastirit të Apolonisë. Mendohet se objekti origjinal është marrë nga Apolonia, që në gërmimet e para arkeologjike gjatë Luftës së Parë Botërore. Më vonë stela u ble dhe gjendet e ekspozuar në mjediset e Muzeut të Vjenës.

# Shkencë në luftë, austro-hungarezët dhe arkeologjia shqiptare

Prof.Luan Përzhita*

Territori i Shqipërisë si pjesë e qytetërimeve antike të Mesdheut që nga koha e Rilindjes Evropiane ishte në fokusin e interesimit të studiuesve të pasionuar për antikitetet. Historia e arkeologjisë shqiptare, përfshin tri faza zhvillimi; a) fillim i shekulli 19-të - 1939, periudhë kjo e dominuar nga udhëtare dhe arkeologe të huaj; b) vitet 1945-1990, që pasqyrojnë një arkeologji të zhvilluar totalisht nga shteti socialist; c) v.1991 deri më sot që është karakterizuar nga transformimi i arkeologjisë kombëtare, ndërthurur me bashkëpunime me misionet e huaja arkeologjike. Në ndryshim nga vendet e tjera të Ballkanit, ku kërkimi sistematik arkeologjik nis nga gjysma e dytë e shek. XIX, në Shqipëri për shkak të formimit më vonë të shtetit të pavarur, ai fillon në periudhën midis dy luftërave botërore. Në epokën e Napolonit interes për arkeologjinë shqiptare treguan britanikët dhe francezët me William Martin Leake, Francois Pouqueville, Leon Heuzey dhe Daumet Honorë. Ata u pasuan nga Theodor Ippen, Paul Traeger Karl Patsch, Camillo Praschnik etj. Interesi i studiuesve austriakë për monumentet arkeologjike në Shqipëri zë fill në fillim të shek. 20, atëherë kur Carl Patsch, boton veprën e tij Sanxhaku i Beratit (1904). Autori ka gjurmuar dhe regjistruar monumentet dhe vendbanimet antike nga Myzeqeja, Berati deri në Vlorë. Dokumentacion shumë i pasur si fotografi, planimetri dhe skica në terren - si dhe përshkrimi i hollësishëm i monumenteve dëshmojnë për një punë shumë serioze.

Patsch ka dhënë kontribut të çmuar dhe në fushën e muzeologjisë, duke ndihmuar drejtpërdrejtë në ngritjen e Muzeut të parë Kombëtar në Shqipëri, në vitin 1922. Të tjerë studiues për t'u përmendur janë Theodor Ippen dhe baroni Franz Nopçe, të cilët vinin nga shërbimi diplomatik austro-hungarez, por kishin interesa të veçantë dhe për trashëgiminë historike të Shqipërisë. Ato u përqendruan kryesisht në Shqipërinë e Veriut dhe prej tyre kemi shumë përshkrime vendbanimesh, kisha dhe monumente, të botuara në periudhën 1900-1908 nga Thedor Ippen. Në radhën e studiuesve që Shqipërinë e patën jo atdhe të lindjes, por vendin e zemrës dhe të punës intelektuale, bën pjesë edhe Theodor Anton Ippen, në atë elitë albanologësh. Theodor Ippen lindi me 29




nëntor 29 nëntor 1861 në Sezemice të Bohemisë, aso kohe pjesë e perandorisë austro-hungareze. Ai emërohet në Shkodër, konsull i përgjithshëm i monarkisë, një njohës i mirë i rrethanave shqiptare, sllave e turke. Ippen ndërmerr udhëtime të shumta në brendësi të luginave të Drinit, drejt Alpeve të Shqipërisë Veriperëndimore e nën Drin, nëpër Mirditë dhe Mat. Interesat e tij janë edhe ato arkeologjike, numizmatike, arkitektonike, historike, religjioze etj.

Botimi i librit "Shqipëria e Vjetër" përkthyer nga studiuesit Gjerak Karaiskaj dhe Ardian Klosi në vitin 2012, sjellin një përmbledhje të katër nga studimet më ta rëndësishme të Theodor Ippen. Kështu libri "Malësia e Shqipërisë Veriperëndimore" është një pasqyrë e hollësishme gjeografiko-etnografike-historike e luginave të degëve kryesore të Drinit, Fanit e Matit. Po ashtu, monografia tjetër "Shkodra dhe ultësira bregdetare e Shqipërisë së Veriut" e shkruar në vitin 1907, që vjen si plotësim i të dhënave më të hollësishme të monografisë së të parë, në të cilën njihemi me panoramën historike të qyteteve ai Shkodra, Kruja e Tirana e asaj kohe. Edhe dy monografitë e tjera ajo mbi kishat dhe mbi monumentet e Shqipërisë së Veriut shquhen për saktësinë e detajit dhe thellësinë e konkluzioneve të këtij personaliteti.

Studiuesi Ardian Klosi ndërmjet të tjerave në hyrje e librit shkruan: "Jemi në sigurt që ky libër edhe pse nuk mund të japë menjëherë tek ne vendin që meriton albanologut të madh, njeriut që vuri, heshturazi, por me forcën e diturive të tij, një pjesë të madhe në themelet e shtetit shqiptar, prapë se prapë është tribute mirënjohjeje për veprën e tij, që rikthehet shqip në vendet, të cilat ai i përshkroi një shekull më parë". Libri "Shqipëria e Vjetër' është i pari botim i plotë në shqip dhe është një vepër e domosdoshme për fushën e albanologjisë.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, së bashku me trupat ushtarake vijnë në Shqipëri, Camilo Praschniker (arkeolog) dhe Arnold Schober (epigrafist), të ngarkuar nga Akademia Perandorake e Shkencave, në Vjenë, për të gjurmuar dhe regjistruar vendbanime dhe monumente nga Mali i Zi në Shqipëri. Ato ndërmorën dy ekspedita, rezultatet e të cilave i botuan në C. Praschniker und A. Schober, Archaeologische Forschungen in Albanien und Montenegro (1919) dhe C. Praschniker, Muzakhia und Malakastra,1922. Brenda territorit shqiptar u dokumentuan një seri vendbanimesh dhe monumentesh kryesisht të periudhave helenistike dhe romake në një zonë që shtrihet nga Shkodra deri në Vlorë dhe Berat, si dhe pjesë rrugësh të peran-

➔

IN MEMORIAM

# Shuhet albanologu francez Christian Gut, kishte në duar "Zylon" e Agollit

Pak ditë më parë, miku i shqipes dhe shqiptarëve, albanologu dhe përkthyesi Christian Gut ndërroi jetë. Në ditët e fundit të kësaj jete, prof. Gut ishte duke rishikuar përkthimin e kapitujve të munguar të romanit përkthyer shkëlqyeshëm nga ai në frëngjisht, "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo". Vajza e shkrimtarit Dritëro Agolli, Elona, ka njoftuar për shuarjen e profesor Christian Gut. Përmes profilit të saj në "Facebook", ajo thotë se lajmin e hidhur të ndarjes nga jeta të mikut të babait të saj ia dha prof. Remzi Pernaska. "Kujtoj ditën kur me rastin e 85-vjetorit të babit ribotuam ndër të tjera edhe 'Zylon'. I lumturuar që më në fund mbante në duar një botim serioz, me kopertinë lëkure, ndër miqtë e shumtë që përmendëm për t'ia dërguar librin, ishte edhe prof. Gut. 'T'i shkruash edhe një letër, e t'i thuash: Do ndeshemi shoku Gut, pasi këtë shprehje e pëlqente shumë Guti', më thoshte babi atë paradite kur mërmërisnim planet tona. Tanimë të dy janë larguar, kanë lënë gjurmën e dhimbjes, por edhe të veprës së tyre fisnike e të pashembullt", shkruan Elona Agolli.

Kristian GYT (Christian GUT, 1931-2018). Albanolog francez, arkivist, historian, anëtar i jashtëm i ASHAK-ut. I lindur në Paris, ai kreu studimet e larta dhe u diplomua si arkivist paleograf (Paris, 1955) e më pas u diplomua dhe për gjuhën shqipe në Shkollën Kombëtare të Gjuhëve të gjalla Orientale (Paris, 1966). Krahas detyrave të tjera, ka qenë përgjegjës i mësimdhënies së gjuhës dhe qytetërimit shqiptar në Institutin Kombëtar të Gjuhëve dhe Qytetërimeve Lindore në Paris (1971-1995), drejtor i Departamentit të Evropës Qendrore e Lindore po aty (1971-1980), përgjegjës




i seminarit të historisë dhe filologjisë shqiptare në Shkollën Praktike të Studimeve të Larta (Sorbonë - Paris, 1972-2002), ekspert i UNESCO-s (1972-1984). Ka botuar studimin "Pashko Vasa, jeta dhe vepra", Prishtinë 2007. Është marrë me kërkime për gjuhën e letërsinë shqipe dhe për historinë e Shqipërisë. Në fushën e gjuhës ka studiuar kontaktet ndërmjet shqipes e maqedonishtes dhe çështje të sistemit emëror e foljor, është bashkautor i metodës "Parlons albanais" (Paris, 1999). Ka botuar disa artikuj përgjithësues për letërsinë dhe folklorin shqiptar në fjalorë të ndryshëm enciklopedikë. Në fushën e historisë ka hulumtuar burime në gjuhën shqipe për historinë e Shqipërisë, inventarin e konsujve të Francës në Durrës, organizimin administrativ, juridik dhe ushtarak të Shqipërisë në v. 1912-1914, veprimtarinë e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (shih) etj. Pjesa më e madhe e botimeve të tij shkencore i kushtohet albanologjisë. Ka përkthyer frëngjisht disa nga veprat më të njohura të letërsisë së sotme shqiptare, si: I. Kadare, "La ville du Sud" (Paris, 1985); D. Agolli, "Grandeur et decadence du camarade Zylo" (Paris, 1990); R. Qosja, "La mort me vient de ces yeuxla" (Paris, 1994), dhe po ai, "La question albanaise" (Paris 1995); "Le Kanun de Lekë Dukagjini" (Pejë, 2001). Ka marrë titullin "Doctor honoris causa" i Universitetit të Tiranës dhe dekoratën "Kalorës i Urdhrit Kombëtar të Legjionit të Nderit". Me ndarjen nga jeta të prof. Christian Gut, albanologjia humbi një nga studiuesit e rëndësishëm të gjuhës, letërsisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi. Akademia e Shkencave e Shqipërisë i ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta familjes, miqve dhe bashkëpunëtorëve të tij.

---

← dorisë romake. Si arkeolog profesionistë Prashniker dhe Shober na kanë lënë dëshmi shumë të vlefshme, që shërbejnë si pikë referimi akoma edhe sot. Atyre u takon merita e identifikimit dhe dokumentimit të rrënojave të Lisosit duke e diferencuar atë nga Akrolisi.

**SHKENCË NË LUFTË**

Studimi topografik i disa qyteteve dhe i shtrirjes së tyre siç është rasti i Durrësit, mbetet po ashtu kontribut i vyer i këtyre dijetarëve. Në qytetin antik të Apolonisë ato bënë dhe disa sondazhe duke na dhënë dhe një planimetri të mureve rrethuese të qytetit, mjaft të detajuar. Gjatë gjurmimeve në terren, ata evidentuan dhe përshkruan po ashtu pjesë rrugësh të perandorisë romake, që kalonin në Shqipëri dhe në Malin e Zi. Prashniker dhe Shober janë autorë zbulimesh dhe deshifrimesh të një vargu monumentesh dhe mbishkrimesh mortore të periudhave greke dhe romake. Vepra e tyre shpeshherë shërben si pikë referimi akoma dhe sot për studimet me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar në shumë krahina të Shqipërisë e të Malit te Zi.

Natyrisht, zhvillimi i një aktiviteti të tillë shkencor në kushte lufte nuk ishte i lehtë, ç'ka mund të kuptohet nga përshkrimet e detajuara që Prashniker dhe Shober u bënë udhëtimeve të tyre. Për fat të keq, me gjithë përpjekjet e tyre, ata nuk munden të realizonin udhëtimin në Via Egnatia, nga Kavaja deri në rrjedhën e sipërme të Shkumbinit. Në parathënie të librit këto studiues thonë se një pjesë të madhe të ekspeditës e kanë kryer në kushte shumë të vështira ku "Në vend të automjetit ecte kafsha e ngadalte e ngarkuar". Ushtria perandorake e asaj kohe na ka lënë dhe disa foto shumë të bukura të disa prej qyteteve dhe vendbanimeve në Shqipëri. Krahas tyre spikasin dukshëm edhe dy emra studiuesish me nacionalitet hungarez. Etnografi i palodhur Franc Baron von Nopsca në vitet 1907, 1912, 1932 dhe arkeologu Árpád Buday. Arkeologu hungarez Arpad Buday me vizitën e tij dy mujore në muajt qershor-korrik 1917, në Shqipërinë Verilindore dhe Kosovën Veriperëndimore, ka lënë pas një vepër me vlera të pazëvendësueshme informative dhe studimore. Në vitin 1917, ai udhëhoqi një ekspeditë kërkimore në Shqipëri. Libri "Kërkime arkeologjike ne Shqipëri", shkruar nga hungarezi Dr. Budaj Arpad në vitin 1917, gjatë luftës, përmban një informacion me vlerë jo vetëm për fushën e arkeologjisë, por edhe për disiplina të tjera të shkencave albanologjike. Në hyrje Dr. Budaj Arpad shfaq mendimin lidhur me titullin e librit, që duhej të pasqyronte kërkimet arkeologjike në trevën që përfshinte krahinën e Hasit dhe Rrafshin e Dukagjinit deri në Mitrovicë. I ndodhur në dilemë, autori vendos që territorin e kërkimeve të tij ta përfshijë me emrin e Shqipërisë. Për këtë ai shprehet: "Veç kësaj nuk qe e mundur t'i jepnim një titull që në masë të plotë t'i përgjigjet brendësisë dhe as t'i jepnim një titull të shkurtër. Një gjë e tillë është e kuptueshme në qoftë se mbajmë parasysh në përgjithësi dhe veçanërisht sot, se sa e vështirë është të përkufizohet Shqipëria, kur diçka tjetër kuptojmë me këto fjalë në pikëpamje politike dhe prapë tjetër gjë kuptojmë në pikëpamje etnografike dhe historike". Nisur nga materiali arkeologjik i grumbulluar, autori mendon se deri në vitin 1917, Rrafshi i Dukagjinit përbënte një 'terra incognita' të Europës, si nga pikëpamja arkeologjike, ashtu dhe nga pikëpamja historike dhe etnografike.



Fokusi i kërkimeve ishte areali Pejë-Klinë, e më pas Mitrovica. Ai në pjesën më të madhe të këtij territori ndoqi gjurmët e Evansit, duke i pasuruar më tej kërkimet e tij me monumente të reja të panjohura më parë. Kështu, në bregun e Bistricës së Pejës, gjurmët e para u zbuluan më 2 qershor 1917. Ishte zbulim i një përmendoreje shumë të rëndësishme, që pasqyronte varret e dy familjarëve romakë. Konstatimet e tij arritën kulmin një muaj më vonë, në korrik 1917, kur në shtratin e mbetur pothuajse pa ujë të Bistricës së Pejës u zbuluan dhe tri mbishkrime latine, në të cilat figurojnë familjet Aelius dhe Ulpius. Studiuesi hungarez Budaj Arpad na ka lënë shënime mjaft interesante (një skicë planimetrike dhe disa fotografi me mjaft vlerë), lidhur me një fortifikim të vëzhguar asokohe në qytetin e Pejës. Këto të dhëna kanë sot një rëndësi të veçantë, pasi ndërtimet e gjysmës së dytë të shek.. XX tashmë i kanë mbuluar dhe zhdukur plotësisht gjurmët e fortifikimit në fjalë. Gërmadhat e Pejës së dikurshme, shkruan Budaj Arpad më dt.17 qershor 1917, "...gjenden mbi një sipërfaqe të rrethuar mirë, në formë katërkëndëshi të çrregullt, me kulla të rrumbullakëta në qoshet, sikurse tregohet në skicë. Gërmadhat janë në afërsi të drejtpërdrejtë të qytetit, në anën veriore të tij, midis rrugës që të çon drejt Mitrovicës dhe lumit të Bistricës në veri të saj". Autori shënon në këtë botim indikacione që lidhen me zbulimin e Municipium DD të Soqaninës, gjurmë të shumta të rrugëve antike në këtë territor, si dhe për një mori qendrash mesjetare të Rrafshit të Dukagjinit. Kështu për kalanë e Sveçanit - thotë Budaj Arpad, - gjoja e ka ndërtuar mbreti Milutin, i cili ka studiuar nga viti 1275-1321. Ai arriti të dallojë mjaft qartë disa faza të ndryshme që përmbante ndërtimi dhe arkitektura e këtij fortifikimi. Duke iu referuar Evansit, ku sipas tij kjo kala ka pasur emrin bizantin, e quajtur Spentza, ai mendon se një gjë e tillë vërtetohet mjaft qartë, si nga strukturat ndërtimore të kësaj kalaje, ashtu dhe nga ekzistenca e një sërë elementesh të tjera, që janë të kohës më të hershme se periudha e sundimit të mbretit Milutin.

**KISHAT**

Duke analizuar më pas dy statuja të gjetura në Banjska të Mitrovicës, që përmbajnë figura luanësh, të zbuluara njëra në oborrin e kazermës së xhandarmërisë, ndërsa tjetra në hyrjen e kishës ortodokse, e cila më pas ishte kthyer në xhami, Budaj mendon se kisha e Banjskës dhe ajo e Deçanit janë afërsisht të së njëjtës kohë. Pas Luftës së II Botërore gërmimet arkeologjike në Shqipëri u ndërmorën kryesisht vetëm nga studiues shqiptar. Sidoqoftë, diçka kishte ngelur nga "e kaluara". Hasan Ceka, i vetmi arkeolog shqiptar që kishte studiuar për arkeologji, para Luftës së Dytë Botërore, në universitetin e Gracit dhe të Vjenës, mund të konsiderohet si përfaqësues i shkollës austriake në gërmimet shqiptare të kësaj kohe. Por këtu duhet theksuar edhe kontributi i gjuhëtareve vjenez si Anton Mayer dhe Hajnc Kronaser, të cilët në vitet '60-të të shek. XX kanë botuar mjaft studime të rëndësishme mbi ilirishten dhe rrënjët e saj të hershme.

Sidoqoftë, interesi austriak për arkeologjinë shqiptare ridimensionohet pas ndryshimeve politike që ndodhën në Shqipëri, në vitet '90 të shek. 20. Në këtë rast interesi ishte dypalësh. Kështu u arrit që të organizohet në vitin 2004 për herë parë, në Austri, një ekspozitë arkeologjike, të emërtuar "Ilirët", e pasur me mbi 300 eksponate origjinale, nga prehistoria deri në periudhën romake, u prezantua në ambientet e muzeut të prehistorisë në Asparn an der Zaya, në Austrinë e Poshtme. Ajo u shoqërua me një katalog të ilustruar me rreth 130 faqe dhe pati interes të gjerë nga mediat. Një nga vlerësimet e shtypit të kohës rreth saj ishte: "Shumëllojshmëria e gjetjeve dhe kualiteti i lartë i tyre dëshmojnë për kulturën e një populli, që jetonte mes grekëve dhe keltëve (velser virtshafts magazine); që kreativiteti nuk është arritje e kohëve moderne, që arti nuk njeh kufij në kohë dhe në hapësirë, këtë na dëshmon ekspozita e mrekullueshme (Pasauer noje prese)". Në vitin 2004-2005 me Prof. Gëzim Hoxhën organizuam një ekspeditë të përbashkët gërmimesh arkeologjike, me Prof. Pohmarskin nga universiteti i Gracit, në qytetin antik - Lisos. Në kuadrin e bashkëpunimeve tona duhet të kujtoj punën e bërë në fushën e përkthimeve. Në vitin 2002 Ardian Klosi dhe Gjerak Karaiskaj përkthyen në shqip "Teodor Ipen, Shqipëria e Vjetër", Tiranë 2002, ndërsa në vitin 2003, Bashkim Lahi solli në shqip veprën e Kamilo Prashniker dhe Arnold Shober, "Kërkime Arkeologjike në Shqipëri dhe Mal të Zi". Besojmë se tani ka ardhur koha për të kaluar në projekte gërmimesh arkeologjike afatgjatë.

***Drejtor i Institutit të Arkeologjisë**

Opinioni i Ditës

# Hapësira e pashfrytëzuar e forcimit të lidhjes mes Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës

Nga Adri Nurellari

(vijon nga faqja 1)

... kemi nisur muajin e fundit të këtij viti, të mbushur me jubile patriotike. Ky vit përveç se ishte 550-vjetori i vdekjes së Skënderbeut, ishte 10-vjetori i pavarësisë së Kosovës, 140-vjetori i Lidhjes së Prizrenit, 110-vjetori i Kongresit të Manastirit dhe 100-vjetori i krijimit të Komitetit të Mbrojtjes së Kosovës. Kjo ishte mbledhja e pestë e mbajtur mes qeverive të Tiranës dhe Prishtinës e spikati për nga retorika dhe simbolika e ndezur patriotike si dhe buja që shkaktuan deklaratat që dolën prej saj. E vërteta është se marrëdhëniet dhe lidhja mes Kosovës dhe Shqipërisë nuk ka qenë kurrë më e mirë ndonjëherë më parë, por nga ana tjetër ka mundësi të jetë shumë më e mirë sesa është tani.

Po të shikohet konkretisht lista e marrëveshjeve në Pejë, aty shikohet se janë marrëveshje normale e karakteristike që janë bërë edhe mes shteteve që kanë marrëdhënie të mira dypalëshe. Pra, qoftë për nga numri e qoftë për nga përmbajtja, nuk janë në nivelin e avancuar që do duhej të ishin për dy shtete me marrëdhënie të shkëlqyera e vëllazërore, sikurse janë dy shtetet tona. Kështu për shembull, marrëveshja për heqjen e roamingut mes dy shteteve tona mund të konsiderohet diçka e vonuar, sepse është tashmë realitet për 28 shtetet e Bashkimit Evropian prej vitit të kaluar si dhe është gjithashtu një nismë rajonale mes vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Nga ana tjetër, janë të tjera marrëveshje të nënshkruara më herët, të cilat janë pluhurosur nga harresa e nuk vihen në jetë. Kështu për shembull, është për të ardhur keq që në kuadër të kalendarit të përbashkët kulturor që u proklamua e nënshkrua që në vitin 2014, nuk kemi ndonjë intensifikim kushedi të aktiviteteve të përbashkëta apo shkëmbimeve. Për shembull, është për të ardhur keq që premierat e baletit apo Teatrit Kombëtar të Kosovës nuk shfaqen në Tiranë dhe anasjellas. Po ashtu, është e padrejtë dhe e pandershme që Kosova e ka si pjesë të detyrueshme të arsimit parauniversitar ekskursionet për të vizituar qytetet kryesore, monumentet, vendngjarjet historike në Shqipëri, ndërkohë që kjo gjë nuk vlen për nxënësit e Shqipërisë.

Në disa raste kemi edhe ripërsëritje, si për shembull themelimi i një dhome tregtie dypalëshe në Pejë, ndërkohë që në një mbledhje të mëhershme ishte firmosur tashmë iniciativa e krijimit të një ode tregtie mbarëkombëtare. Me pak fjalë, marrëveshjet dhe veprimet konkrete janë shumë më poshtë, krahasuar me retorikën dhe ngjyrat e ndezura kuq e zi që shoqërojnë këto takime.




Për hir të së vërtetës, duhet thënë madje se takimet mes dy qeverive tona nuk duhet as të konsiderohen si ndonjë simbolikë e madhe e nivelit të ngushtë të marrëdhënieve. Vendet fqinje tonat kanë bërë këtë lloj takimesh ndërqeveritare të shumta me vendet që i rrethojnë. Kështu për shembull, ndërsa ne rrahim trumbetat e mbledhjeve tona, Serbia tashmë jo vetëm ka bërë takime me të gjitha vendet fqinje, me përjashtim të Kosovës, por edhe ka organizuar tri mbledhje ndërqeveritare me Italinë. Republika e Shqipërisë mezi e ka bërë një mbledhje tjetër ndërqeveritare me Maqedoninë, ndërkohë që Kosova ka dy- tri vite që e përflet për ta bërë një me Maqedoninë, por ende nuk e ka materializuar. Kjo do të thotë se jo vetëm që këto mbledhje të shpeshta nuk po thellojnë marrëdhëniet ndërshtetërore në nivelin e duhur e të mundur, por në njëfarë mënyre duke u marrë vetëm me njëri-tjetrin, po na largojnë nga të tjerët. Pra, është një kosto oportune që nuk po thellojmë marrëdhëniet me shtete të tjera fqinje me të cilat kemi lidhje të mira e mundësi për të bërë mbledhje ndërqeveritare sikurse mund të jenë Kroacia, Hungaria, Bullgaria, Mali i Zi apo Sllovenia.

Fatmirësisht, edhe pse si dy shtete institucionalisht e procedurialisht nuk po merren iniciativa intensive për të forcuar e thelluar bashkëpunimin mes dy shteteve, populli vetë po e bën këtë bashkim në mënyrë spontane e të natyrshme. Dora e fshehtë e tregut ka bërë punën e vet dhe tanimë të dyja shtetet jemi bërë partnere kryesore tregtare për njëra-tjetrën. Kosova është destinacioni i dytë i eksporteve të Republikës së Shqipërisë me 151 milionë euro të eksportuara në vitin 2017. Nga ana tjetër, Shqipëria është destinacioni numër një i eksporteve të Kosovës me 60 milionë euro të eksportuara gjatë vitit të kaluar. Ky volum tregtar vështirë se mund të rritet më shumë për sa kohë të dy ekonomitë tona e kanë strukturalisht sektorin e prodhimit të brishtë e të kufizuar. Pra, jemi duke tregtuar me njëri-tjetrin maksimumin e asaj që mund të prodhojmë, sepse të dyja ekonomitë tona janë ekonomi importuese. Po ashtu, një tjetër indikator i rëndësishëm është se Rruga e Kombit nuk po shfrytëzohet vetëm me një drejtim, sepse është rritur ndjeshëm çdo vit numri i turistëve që kanë ardhur në Kosovë prej Shqipërisë. Shqipëria përbën vendin numër një të origjinës së turistëve që vijnë në Kosovë, me më shumë se çerekun e vizitorëve. Mirëpo po të kemi parasysh se një pjesë e mirë e diasporës kosovare në Gjermani e Austri kanë vetëm shtetësinë e këtyre vendeve pasi në to nuk lejohet dyshtetësia, atëherë i bie që kjo përqindje e shtetasve të Shqipërisë në kuadër të vizitorëve që realisht janë prej jashtë Kosovës, të jetë edhe më e madhe. Po ashtu, për të disatin vit radhazi Republika e Shqipërisë është vendi i tretë në renditje për sa u përket investimeve të drejtpërdrejta të huaja. Prej çlirimit të Kosovës dhe hapjes me Shqipërinë llogariten mbi 19 mijë martesa ndërshtetërore dhe një numër gjithnjë në rritje të qytetarëve që kanë shtetësi të dyfishtë, ku përfshihem këtu edhe unë. Kjo tendencë do të thotë se atë që nuk e bën shteti, po e bëjnë natyrshëm qytetarët.

Në gjithë këto 19 vite prej çlirimit të Kosovës, mund të thuhet pa kurrfarë dyshimi se nisma më e rëndësishme mes Shqipërisë e Kosovës, e bërë deri tani ngelet ende Rruga e Kombit e ndërmarrë para 10 vitesh, pra shumë kohë përpara se të fillonin mbledhjet mes dy qeverive. Edhe një projekt tjetër me rëndësi që u bë me fonde gjermane, e që ishte linja e interkonjeksionit së rrymës elektrike mes Shqipërisë e Kosovës, ende nuk është vënë në funksion si pasojë e sabotimit të Serbisë. Me sa duket, ky projekt nuk ka ndonjë peshë të madhe për qeverinë aktuale të Shqipërisë, sepse nuk ka bërë ndonjë presion ndaj Beogradit për ta zhbllokuar këtë projekt.

Ndërkohë që ka të tjera projekt-ide të mëdha infrastrukturore, që vetëm shtetet mund t'i bëjnë, të cilat do të duhej së paku të trajtoheshin e merreshin në konsideratë në këto takime. Të tilla mund të ishin ndërtimi i një hekurudhe nga bregu i Adriatikut deri në Prizren, ndërtimi i një degëzimi të gazsjellësit të TAP deri në kufirin e Kosovës, sigurimi i qasjes së lirë në det për Kosovën dhe dhënia në përdorim i lehtësirave portuale tona ndaj doganës së Kosovës. Është për të ardhur keq që prej ofrimit të portit të Shëngjinit për Kosovën një dekadë më parë nga ish-kryeministri Berisha, asgjë konkrete nuk është bërë për t'i dhënë Kosovës qasje të lirë në det. Po ashtu, me interes mund të ishte ndërtimi i një tubi naftësjellës prej Shëngjinit deri në Prizren, që do të mund të shoqërohej me ndërtimin e një rafinerie nafte në formën e Partneritetit Privat-Publik, i cili do të garantonte sigurinë energjetike të Kosovës. Ky projekt mund të imitonte atë që ka bërë Maqedonia me rafinerinë e Kumanovës, e cila është e lidhur me një tub naftësjellës me Selanikun.

Kemi gjithashtu hapësirë të madhe për të investuar së bashku në energjetike. Shqipëria harxhoi 130 milionë dollarë si pjesë e një projekti të dështuar të financuar nga Banka Botërore për të ndërtuar një termocentral me gaz natyror në bregdetin e Vlorës, i cili sot është jashtë funksionit. Më mirë do ishte që të kishim ndërtuar në zonën kufitare të Kukësit një termocentral që do furnizohet me linjitin e pamatë të Kosovës ose që të merrnim pjesë si bashkinvestitore në termocentralin Kosova C. Nga ana tjetër, nuk do ishte ide e keqe që edhe Kosova të pluralizonte burimet energjetike dhe të ishte bashkinvestitore me qeverinë e Shqipërisë për projektin e hidrocentralit të Skavicës.

Një tjetër ide me vlerë do të ishte një projekt i madh ndërshtetëror për një kompleks ndërkufitar të turizmit malor. Tanimë që projekti madhor i Brezovicës nuk u realizua, përse të ngelemi peng i këtij projekti kur potenciali për pista skijimi e resorte të turizmit dimëror janë të shumta tjetërkund. Kështu për shembull, malësia e Dragashit mund të kombinohej fare mirë me pjesën e Shishtavecit dhe Lumës për të studiuar e projektuar një resort të ri malor nga e para. Në Shqipëri zona e Shishtavecit është zona me traditën më të madhe të skijimit. Në këtë projekt madje mund të përfshihet edhe Maqedonia. E njëjta gjë vlen për potencialin e jashtëzakonshëm që kanë edhe Bjeshkët e Nëmuna. Kështu për shembull, pjesa e bjeshkëve të Belegut në Kosovë mund të ishte kombinuar me Dobërdolin, Sylbicën, Trokuzin në Shqipëri si dhe me pjesën e Bogiqevës në Mal të Zi për të bërë një qendër fenomenale skijimi treshtetërore. Të tilla projekte funksionale e të suksesshme janë të shumta që mund të imitohen, sepse janë ndërtuar tashmë prej dekadash mes Zvicrës e Francës, Zvicrës e Italisë, Francës e Italisë, Gjermanisë e Austrisë, Italisë e Austrisë e kështu me radhë.

Përpos kësaj, ka mundësi të jashtëzakonshme për të bashkëpunuar edhe në sfera të tjera, ku kemi të dyja shtetet mangësi e mund të ndajmë kostot. Për shembull, mund të mendojmë seriozisht që të blejmë bashkë si dy shtete avionë të specializuar për shuarjen e zjarreve duke ndarë shpenzimet. Ne mund të ndërtojmë një njësi ajrore zjarrfikëse dhe kërkim-shpëtimi të vendosur në aeroportin e Gjakovës apo Kukësit, që t'i shërbejë të dy shteteve në rrezik apo nevojë. E njëjta gjë mund të bëhet ta zëmë për të ndërtuar një shkollë pasuniversitare cilësore për biznes e administrim dyshtetëror ndërkufitar, siç është universiteti i Viadrinës mes Gjermanisë dhe Polonisë në Frankfurt, mbi Oder dhe Slubice. Po ashtu, mund të investojmë bashkë për një laborator të avancuar, që merret me analiza ADN e të tjera të ngjashme, të cilat sot i bëjmë jashtë vendit. Me këtë logjikë mund të ndërmarrim investime të përbashkëta për projekte kapitale si për shembull të ndërtojmë një observator astronomik në malet ndërkufitare, një planetarium, një arboretum apo park botanik, një fshat olimpik të përbashkët, një institut apo shkollë të përbashkët restaurimi etj., etj.

Këto janë vetëm disa propozime potenciale që japin një ide se sa shumë gjëra të përbashkëta mund të bëjnë këto dy shtete të banuara nga shqiptarët. Këtu nuk bëhet fjalë për të shpikur rrotën, sepse ka projekte e modele të panumërta për të imituar. Duke nisur nga traktati Cobden-Chevalier, të nënshkruar mes Francës dhe Anglisë në 1860, i cili kishte një logjikë shumë praktike të tipit: ajo që është legale në këtë anë të kufirit, pranohet si legale edhe në anën tjetër. Po ashtu, mund të huazojmë praktikat e Beneluksit, që e ka nisur më herët se Bashkimi Evropian integrimin ndërshtetëror. Po ashtu, mund të mësojmë nga politikat dhe praktikat e rasteve të ngjashme me Kosovën e Shqipërinë të shteteve që kanë popullsi të së njëjtës kombësie, sikurse janë për shembull Qiproja dhe Greqia. Po ashtu, mund të imitohen praktikat dhe iniciativat bilaterale të shteteve të tjera, që kanë marrëdhënie të shkëlqyera me një shtet tjetër, sikurse janë për shembull SHBA dhe Kanada, Australi e Zelandë e Re, Mbretëri e Bashkuar dhe Irlandë etj. Prandaj në një reflektim për këtë vit jubilar që po mbyllet, mund të thuhet se të dyja shtetet kanë bërë goxha avancime në forcimin e marrëdhënieve me njëra-tjetrën, ama ekziston një hapësirë e jashtëzakonshme e pashfrytëzuar për ta intensifikuar e konsoliduar edhe më tej këtë marrëdhënie.

Opinioni i Ditës

# Janullatos, a nuk i vrasin edhe shqiptarët kështu?

Nga Gazmend Kapllani

*(vijon nga faqja 1)*



... Në mediat greke ka heshtje të plotë për këtë ngjarje. Policia greke mundohet ta mbulojë duke bërë fjalë për sherr banal.

Personalisht jam kërcënuar shpesh nga fashistët në Greqi dhe ishte një nga shkaqet kryesore që më bëri të ikja nga Greqia. Kjo nuk është as vrasja e parë e një emigranti në Greqi - jo vetëm shqiptar - as e fundit. Por në këtë moment të paranojës nacionaliste në Greqi vrasjet dhe sulmet ndaj shqiptarëve (sidomos), por edhe emigrantëve të tjerë mund të marrin përmasa masive dhe vrastare të papara deri më sot.

Përveçse vetë emigrantët dhe pjesa antifashiste e shoqërisë greke duhet të organizohen që të parandalojnë masakrën, shteti shqiptar nuk mund të heshtë dhe të bëjë sikur nuk po ndodh asgjë. Është bashkëpunim me krimin, heshtja në këtë rast. Të kërkojë me ngulm nga autoritetet greke sqarimin dhe ndjekjen e ngjarjes. Të sensibilizojë ambasadorët e BE-së në Tiranë, në lidhje me klimën e urrejtjes (të krijuar dhe të ushqyer çdo ditë nga media, kisha, politikanë) që përjetojnë emigrantët shqiptarë dhe në përgjithësi emigrantët dhe pakicat në Greqi. Të ndalojë menjëherë hyrjen në Shqipëri të çdo individi të lidhur direkt apo indirekt me grupet naziste dhe ultra-nacionaliste greke.

Dhe shpresoj që Hirësia e tij, Anastastasi, të mund të luajë një roj paqësor mes dy vendeve dhe që aq i gatshëm ishte të ngushëllonte familjen e Kaficës, një talibani me kallash, që urrente çdo gjë shqiptare dhe njerëzore rreth vetes, të ngushëllojë edhe familjen e të ndjerit Petrit Zilfo, një njeriu paqësor që u ther si qen vetëm për shkak të origjinës së tij, sepse nuk mund të pranonte ofendimet e renda të një nazisti.

Ndryshe, për mua të paktën, është një prift kryekëput i dështuar dhe hipokrit. Boll më! Basta Ya!




## HOROSKOPI

### DASHI
Personat e shenjës së Dashit duhet të përpiqen të gjejnë kompromis. Ka gjasa të përballeni me probleme në punë. Për t'i shmangur ato, bëni kujdes kur flisni me shefat tuaj. Në mbrëmje përpiquni të gjeni mënyrën më të mirë për t'u relaksuar.

### DEMI
Mund të gjeni kohë për t'iu përkushtuar paraqitjes suaj të jashtme. Do të bëni disa blerje, të cilat do t'ju ndryshojnë një pjesë të mirë të garderobës suaj, çfarë do t'ju ndihmojë për një udhëtim që do të realizoni së shpejti.

### BINJAKET
Shumë persona të kësaj shenje do të komunikojnë lehtë me brezin e ri. Përpiquni t'u jepni atyre jo vetëm njohuri, por t'iu flisni edhe për ndjenjat shpirtërore. Ka gjasa që të mbrëmje të kërkoni mendimin e një personi me shumë përvojë, lidhur me një çështje që po ju mundon.

### GAFORJA
Mund të realizoni disa takime të rëndësishme gjatë kësaj të mërkure, të cilat do t'ju vlejnë shumë në aspektin profesional. Mbrëmja do të jetë shumë më e qetë. Ka gjasa të gjeni një objekt të çmuar ndërkohë që pastroni shtëpinë.

### LUANI
Shumë persona të kësaj shenje do të kënaqen nga arritjet e tyre. Falë zgjuarsisë që ju karakterizon, mund të zgjidhni një çështje të caktuar nga e cila varet e ardhmja juaj. Sa i përket jetës personale, mund të përballeni me një mosmarrëveshje të vogël me partnerin/partneren tuaj.

### VIRGJERESHA
Mos shpenzoni më shumë se buxheti juaj sot, pasi do të rrezikoni ekuilibrin ekonomik. Gjithashtu, refuzoni personat që iu kërkojnë borxh. Mendohuni mirë para se të ndërmerrni një vendim të caktuar, sepse mund të pendoheni më pas.

### PESHORJA
Disa persona të kësaj shenje do të kenë disa ide sesi mund ta përmirësojnë jetën e tyre personale. Megjithatë, ky nuk duhet të jetë fokusi i vetëm për ditën e sotme, pasi keni edhe shumë detyra të tjera për të përmbushur. Mos bëni lëvizje të mëdha në aspektin ekonomik.

### AKREPI
Mos besoni në krijimin e një aleance apo tek partneriteti në biznes. Qëndroni larg një skeme të tillë. Kjo do t'ju bëjë edhe më të fuqishëm. Sa i përket jetës personale, do t'ju shoqërojë fati i mirë.

### SHIGJETARI
Nuk do të ndiheni aq në formë sa për të realizuar dëshirat tuaja. Modestia do t'ju pengojë të arrini qëllimet. Kas gjasa të keni frikë t'i tregoni partnerit/partneres suaj diçka me shumë rëndësi për ju. Në jetën profesionale, do të jeni shumë të vendosur.

### BRICJAPI
Do të shënoni sukses në karrierë ose në ndonjë marrëveshje biznesi. Mos harroni t'i përkushtoheni shëndetit. Ushtrohuni sa më shumë fizikisht, pasi kjo do t'ju ndikojë vetëm pozitivisht.

### UJORI
Do të kaloni një ditë të lodhshme dhe të vështirë. Kjo mund të vijë edhe për shkak të problemeve në familje apo mungesa e partnerit/partneres së duhur për të përmbushur detyrat që i takojnë.

### PESHQIT
Për disa persona të kësaj shenje, detyra më e vështirë për ditën e sotme do të jetë pajtimi me një familjarin tuaj. Bëni kujdes me fjalët, pasi mund të ofendoni personat rreth jush. Do të ishte mirë që sot të mos përfshiheshit në çështje financiare.

## Ultrasit bëhen palë me Ze Marian

# "Fanatics": Të largohen Halili, Çomo dhe Laçi!

Grupimi "Tirona Fanatics" vazhdon luftën kundër klubit bardhelu për situatën e vështirë që po kalon skuadra kryeqytetase. Por, në postimin e sotëm në rrjetet sociale, grupimi nuk iu është kundërvënë publikisht vetëm drejtuesve, por tashmë edhe lojtarëve, më saktësisht atyre që ishin pjesë e skuadrës edhe në edicionin kur ajo ra nga kategoria. "Fanatics" reaguan pas një intervistë të dhënë nga Ze Maria për "Panorama Sport", ku fajësonte drejtorin sportiv Arbi Laçi (me këtë të fundit që ka një të kaluar si ish-"Fanatics") për problemet e Tiranës, pasi kishte bërë një merkato plotësisht të gabuar. Ze Maria është i bindur se Tirana do të ndryshojë kur edhe menaxhimi të behet nga njerëz të tjerë. "Halili u tregua një kavalier i vërtetë, por nuk mund ta lërë klubin në dorë të një ish-kapo ultrasi. Ai nuk kupton asgjë nga futbolli", thotë ish-trajneri i bardhebluve. Edhe "Fanatics" ndajnë të njëjtin mendim me trajnerin, të cilin në fund e kanë përshëndetur shumë përzemërsisht, të bindur se kjo situatë nuk ishte aspak faji i tij. "Deklaratat e ish-trajnerit bardheblu, Ze Maria, janë pikërisht ato deklarata, të cilat TF tashmë ka kohë që i përsërit e ripërsërit. Fajtorët kryesorë të gjendjes së mjerueshme ku ndodhet sot Tirona, janë pseudodrejtuesit e pseudoklubit bashkë me pseudopresidentin. Refik Halili, Hektor Çomo dhe Arbi Laçi janë ata, që së bashku kanë punuar vetëm e vetëm për përfitime personale dhe në dëm të sport klubit, e janë ata dashakeqësit e vërtetë të Tironës. Sa më shpejt të largohen të tre, bashkë me pseudo-senatorët që ishin protagonistë në rënien e klubit, aq më mirë do të jetë për të gjithë. 'Tirona Fanatics' i uron fat Ze Marias për karrierën e tij në vazhdim!", shkruhet në komunikatën e njërit prej tifogrupeve bardheblu.



Jeton Selimi

Presidenti i Kukësit rrëfen prapaskenat me Musollin dhe sfidat si pritëse do luhen në Kamëz

# Gjici: Katër blerje dhe jemi për titull

## "Në vitin 2019 pritet të ndërtohet stadiumi i ri"

Presidenti i Kukësit, Safet Gjici, flet për të gjitha temat të klubi i Kukësit. Në një prononcim për "Supersport", numri 1 i klubit verilindor sqaron çështjen e stadiumit në Kukës, impiantin ku do të luajë tani e tutje, si edhe për rastin e fundit, "Musolli".

**RIVALITETI**

"Unë besoj se ky kampionat është më i forti nga të gjithë vitet e tjera. Më përpara kanë qenë 3-4 ekipet e para që e bënin luftën, ndërsa sivjet janë të gjitha të forta. Rasti i freskët, ku ekipi i vendit të fundit mund ekipet më lart. Edhe ne me Gjirokastrën fituam me vështirësi, apo edhe me Kamzën.

**STADIUMI**

"Ju e dini mirë që kryeministri Rama, në mbledhjen e qeverisë që pati në Kukës, e shpalli vendimin për të bërë stadiumin e ri. 50% qeveria dhe 50% federata. Kam kontaktuar në federatë dhe është mbyllur procedura e tenderit të projektimit. Është në fazat e mbylljes edhe procedura e tenderit të zbatimit. Unë besoj se nga fundi i dhjetorit, do fillojë prishja te stadiumi aktual dhe besoj fort se me kompaninë që do fitojë tenderin e zbatimit, që ta mbyllim punën brenda 6 muajve të parë të vitit tjetër.



**NDESHJET SI PRITËS**

"Tashmë kemi bërë një marrëveshje me Kamzën dhe ndeshjet brenda në shtëpi do i luajmë në Kamëz. Tifozët kuksianë nuk kanë pasur mundësi që ta ndjekin Kukësin kudo dhe ne po bëjmë përpjekje që t'ua çojmë Kukësin aty ku janë më afër. Edhe në Kamëz vijnë e shikojnë ndeshjen, edhe nga Kukësi, nuk kanë pse futen në Tiranë, në atë trafik".

**SKËNDERBEU**

"Skënderbeu është Skënderbeu, ka stofin e vet. Nuk është Skënderbeu i viteve që kemi luftuar denjësisht për kampionat, por gjithsesi ngelet Skënderbeu. Pa diskutim që tifozët e kuptojnë që është një ndeshje e rëndësishme dhe duhet ta mbështesin ekipin e zemrës. Them se ndeshja do jetë e fortë, por besoj shumë te stafi dhe ekipi që ta fitojmë ndeshjen".

**MERKATO**

"Edhe Ramadan Ndreu, edhe Nexhipi, po mundohen të gjejnë lojtarë, jo shumë, sepse kemi kufizime tani në janar. Por, 2-3 lojtarë të rëndësishëm, qoftë edhe 4, por që të bëjnë diferencën. Ne jemi gati që t'ia plotësojmë kërkesat Cungut që ekipi të forcohet, sepse kampionati çdo javë e më shumë, sa vjen e forcohet".

**MUSOLLI**

"Unë në marrëveshjen e parë që bëra me Musollin, i thashë: 'Musoll, nëse ti nuk gjen ekip në Kosovë, ti derën e ke si derën e shtëpisë tënde. Duhet t'i biesh në shqelm e ta hapësh'. Nuk ka lidhje fare, Musolli është i rëndësishëm për ne. Jo vetëm Musollin, por askënd nuk flakim në rrugë. Është dëmtuar, ka ecur shpejt me riaftësimin. Do shkojë në Turqi në fazë përgatitore dhe atje do jetë një grup special, që do merret me Musollin. Besoj që nga shkurti do jetë gati për ne. Është i domosdoshëm për Kukësin. Ai mbetet lojtar i Kukësit, deri sa të lërë futbollin".

**OBJEKTIVI**

"Ju e dini objektivin tonë, është vetëm titulli kampion"!

**SUPERLIGA**

JAVA E 16-të

| | |
|---|---|
| **TË PREMTEN** | |
| Kukësi - Skënderbeu | 14:00 |
| **TË SHTUNËN** | |
| Tirana - Kastrioti | 14:00 |
| Teuta - Partizani | 17:00 |
| **TË DIELËN** | |
| Kamza - Luftëtari | 14:00 |
| Flamurtari - Laçi | 17:00 |

RENDITJA

| Skuadra | N | P |
|---|---|---|
| Partizani | 15 | 34 |
| Skënderbeu | 15 | 30 |
| Teuta | 15 | 28 |
| Kukësi | 15 | 27 |
| Laçi | 15 | 26 |
| Flamurtari | 15 | 22 |
| Luftëtari | 15 | 13 |
| Tirana | 15 | 11 |
| Kastrioti | 15 | 10 |
| Kamza | 15 | 9 |

**SKËNDERBEU**

# Shehi me "dhimbje koke", Muzaka rrezikon Kukësin

Skënderbeu ka nisur që sot përgatitjet për ndeshjen shumë të rëndësishme të fundjavës, atë kundër Kukësit. Përtej rivalitetit të ndezur mes dy skuadrave në vitet e fundit, korçarët nuk duan të rrëshqasin më shumë në klasifikim për të lejuar Partizanin të largohet, ndaj pritet në këtë duel një kthesë pas asaj humbjeje në shtëpi kundër Teutës. Por trajneri Shehi rrezikon të mos ketë në dispozicion një prej elementëve më cilësore të skuadrës së tij. Gjergji Muzaka la fushën e lojës i dëmtuar në ndeshjen ndaj Teutës, problem të cilin e ka vuajtur edhe këto ditë dhe pjesëmarrja e tij në ndeshje është në dyshim. Mesfushori është i paprekshëm në formacionin e korçarëve dhe ka qenë një ndër elementët më vendimtarë për skuadrën në këto javë të para të kampionatit. Ndaj mungesa e tij kundër Kukësit do të ishte një shqetësim më shumë për t'u zgjidhur në momentin kur në radhët e ekipit mungon edhe Krasniqi.



## Shënojnë në ndeshjet e Kupës

# Cikalleshi dhe Latifi rikthehen te golat

Sokol Cikalleshi është rikthyer përsëri protagonist në Turqi. Sulmuesi kavajas duket se arrin të "nuhasë" golin kur bëhet fjalë për ndeshjet e Kupës. Shqiptari ka arritur të shënojë golin e tij të dytë në po kaq ndeshje për ekipin e Goztepe. Edhe pse golat mungojnë në kampionat, sulmuesi nuk i "kursen" golat e tij për në ndeshjet e Kupës, duke dhënë maksimumin dhe duke nxjerrë në pah potencialin e tij të vërtetë. Cikalleshi është kthyer në një "kartë të fshehtë" për ekipin nga Turqia për sa u përket ndeshjeve në Kupë, të cilat duket se janë të preferuarat e tij. 14 është kuota e golave që bomberi shqiptar ka arritur në këtë kompeticion që kur ai ka zbarkuar në Turqi në vitin 2015. Gjithashtu, edhe Liridon Latifi ka gjetur rrugën e rrjetës në kupë ndaj Penygior, teksa skuadra e tij fitoi me rezultatin e thellë 0-6 në transfertë, duke ndihmuar kështu Pushkash Akademinë që të kualifikohet mes 16 më të mirave të Hungarisë. Ishi i Skënderbeut shënoi golin e 3-t në minutën e 78-të, teksa u aktivizua nga trajneri si titullar. Edhe pse roli i tij natyral është mesfushor krahu ofensiv, Latifi u aktivizua si sulmues i mirëfilltë në këtë sfidë. Për sa i përket aktivizimit në kampionat, ka qenë me pikatore. Në 5 ndeshjet e fundit futbollisti i Kombëtares shqiptare është aktivizuar vetëm 84 minu-





www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al